



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK SHKODËR

Bashkia Shkodër, Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër,

Tel +355 22 400 206

V E N D I M

Nr. 5, datë 31.01.2014

Për buxhetin e vitit 2014 te Bashkisë Shkodër

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 31.01.2014, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 19, pika 1-8, nenin 32 pika “dh”, nenin 33 pika 3 të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 “Mbi procedurat dhe standartet e zbatimit të buxhetit”, ligjin nr. 185/2013, date 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Analizës së Buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2013.
2. Miratimin e Buxhetit të Bashkisë së Shkodër për vitin 2014, si më poshtë :
 - Burimet e Financimit të Bashkisë Shkodër për vitin 2014, janë në shumën **784 427 mije lekë**, te detajuara si më poshtë:

• Transferta e pakushtëzuar	shuma	411 027 mije
• Të ardhurat nga taksa vendore	shuma	197 000 mije
• Të ardhurat nga tarifatat vendore	shuma	150 500 mije
• Të ardhurat jotatimore	shuma	25 900 mije
 - Plani i shpenzimeve të Bashkisë Shkodër për vitin 2014, është në shumën **784 427 mije lekë**, detajuar si më poshtë:

• Shpenzime personeli	shuma	223 460 mije
• Shpenzime të tjera korente	shuma	395 693 mije
• Shpenzime për investime	shuma	165 274 mije
3. Miratimin e detajimit të Buxhetit të Bashkisë Shkodër për vitin 2014 si më poshte:
 - Miratimin e planit të të ardhurave të Bashkisë Shkodër sipas tabelës Nr. 2 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - Miratimin e detajimit të Buxhetit 2014 të Bashkisë Shkodër sipas programeve të paraqitura në pasqyrat Nr.3 dhe Nr.4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - Miratimin e detajimit të Buxhetit të vitit 2014 analitik sipas pasqyrave Nr.5, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Detajimi brenda programeve është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë Shkodër.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Bardhyl LOHJA

BASHKIA SHKODËR

Analiza e Aktivitetit Ekonomiko-Financiar të Vitit 2013 dhe Plan Buxheti i Vitit 2014

PËRMBAJTJA

Analiza e Aktivitetit Ekonomiko-Financiar

	<i>faqe</i>
1. PAMJE E PERGJITHSHME	3
2. TE ARDHURAT	5
3. SHERBIMET PUBLIKE	12
4. PLANIFIKIMI URBAN	23
5. DREJTORIA SH. SOCIALE, ARSIMIT, KULTURES, SPORTEVE, GRUAS	26
6. DREJTORIA E PROMOVIM ZHVILLIMIT, STATIST. & DREJT. K. P. M. N	40
7. DREJTORIA JURIDIKE DHE ASETIVE	46
8. DREJTORIA ORGANIZIMIT, PERSONELIT, SHERB. MBESHTETESE, PROTOKOLL ARKIVIT DHE INFORMATIZIMIT	50

Plan Buxheti i Vitit 2014

	<i>faqe</i>
1. BURIMET E FINANCIMIT	53
2. TE ARDHURAT	54
3. TE ARDHURAT NGA BURIMET KOMBETARE	55
4. KAPITULLI I SHPENZIMEVE	64
5. SHERBIMET PUBLIKE	70
6. DREJTORIA PLANIFIKIMIT DHE KONTR. TE ZHV TE TERRITORIT	89
7. DREJTORIA SH. SOCIALE, ARSIMIT, KULTURES, SPORTEVE, GRUAS	91
8. DREJTORIA E PROMOVIM ZHVILLIMIT, STATIST. & DREJT. K. P. M. N	119
9. DREJTORIA ORGANIZIMIT, PERSONELIT, SHERB. MBESHTETESE, PROTOKOLL ARKIVIT DHE INFORMATIZIMIT	124

Bashkia Shkoder per miratimin e buxhetit te vitit 2014 eshte mbeshtetur ne referencen ligjore te meposhtme:

- I. Ligji Nr. 8652, date 31. 07. 2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”
 - Neni 15: Percakton parimet mbi te cilat do te behen financimet e njesive te qeverisjes vendore; “ato garantojne autonomine dhe funksionimin e qeverisjes vendore nepermjet njohjes se te drejtes se llojshmerise se burimeve ne formen e tatimeve, taksave, tarifave e te ardhurave te tjera, te transferuara nga pushteti qendror; dhenies se autoritetit per krijimin e te ardhurave per krijimin e te ardhuarve ne menyre te pavaruar; dhenien e fondeve te kushtezuara nga qeverisja qendrore ne funksion te kompetencave te deleguara dhe nepermjet dhenies se te drejtes per hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit te vet vjetor”.
 - Neni 16: Te ardhurat e veta te Bashkise ku percaktohen llojet e te ardhurave, baza, kufijte e nivelit te tyre; percaktohen te drejatat e perdorimit te pronave publike, te dhenies se lejeve, autorizimeve, çertifikatave si dhe sherbime te tjera ekskluzive lokale.
 - Neni 17: Percaktohet pjesemarrja lokale ne tatimet kombetare, duke perfshire transferta te kushtezuara dhe te pakushtezuara
 - Neni 19: Percakton parimet kryesore per hartimin e buxhetit lokal si: “buxheti te jete gjithmone i balancuar; te perfshije elementet e shpenzimeve dhe te ardhurave; transfertat e kushtezuara te perdoren vetem per qellimin e dhene dhe qe nuk trashegohen ne vitn pasardhes; te ardhurat vendore qe nuk jane te kushtezuara te perdoren per qellime qe percaktohen nga organi vendimmarres dhe trashegohen ne rast se nuk harxhohen; krijimi i fondit rezerve ne masen deri ne 3% te shpenzimeve te planifikuara”;
 - Neni 32: “detyra me e rendesishme e Keshillit eshte miratimi i buxhetit vjetor si dhe i ndryshimeve dhe amendamenteve gjate vitit mbi buxhetin. Me fuqizimin e autonomies vendore dhe thellimin e metejshem te decentralizimit fiskal, buxheti behet nje instrument i rendesishem qeverises. Keshilli ndjek nga afer gjithte proceduren e pergatitjes, miraton dhe ndjek miratimin e buxhetit nepermjet komisionit te finances”.

II. Ligji nr. 9936 Date 26. 6. 2008 “ *Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise*”

- Neni 6: ku thuhet “ Buxheti vendor perfshin te gjitha te ardhuart, shpenzimet dhe financimet e njesise se qeverisjes vendore..... Buxheti vendor eshte i balancuar pervec rasteve kur merrret hua per financimin e projekteve te investimeve. Buxheti vendor eshte i balancuar ne termat e arketimeve dhe te pagesave. Te gjitha te ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit vendor jane ne terma bruto”.
- Neni 16: ku thuhet “Keshilli i njesise se qeverisjes vendore, me vendim te vecante, miraton te ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore per njesite e qeverisjes vendore dhe fondet speciale te tyre, me qellim kryerjen e shpenzimeve per ushtrimin e funksioneve qe kane, si dhe huamarrjen, per financimin e projekteve te investimeve. ”
- Neni 17: ku thuhet “Kryetari i njesise se qeverisjes vendore propozon drejtimet kryesore te politikës se njesise se qeverisjes vendore dhe projektbuxhetin ne keshillin perkates te njesise se qeverisjes vendore. ”
- Neni 32: ku thuhet “ Keshilli i qeverisjes vendore brenda dates 31 dhjetor, miraton buxhetin vendor ne baze te vlersimit te te ardhurave dhe te transfertave te pakushtezuara, te percaktuara ne ligjin e buxhetit vjetor. ”
- Neni 44: ku thuhet: “Për njësitë e qeverisjes vendore, kur buxheti miratohet në nivel programi:
 - ❖ rishpërndarjet ndërmjet programeve miratohen nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore;
 - ❖ rishpërndarjet e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program, miratohen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore;
 - ❖ rishpërndarjet ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program, miratohen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore;
 - ❖ rishpërndarjet brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese, miratohen nga nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes vendore, nga e cila varet njësia shpenzuese. ”

III. Ligji 10296 date 26 Korrik 2010 “ *Per menaxhimin financiar dhe kontrollin*”

- Kreu II: Përgjegjeshmeria menaxheriale
- Kreu III: Harmonizimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit



Te ardhurat e Bashkise Shkoder perbehen nga:

I. TE ARDHURAT E VETA

sipas kategorive:

1. Te ardhura nga taksa vendore:

Taksa vendore e biznesit te vogel

Zbatohet nga çdo subjekt, kur e ardhura bruto vjetore gjate vitit fiskal eshte me e vogel ose e barabarte me 8. 000. 000 Leke. Kategorite e bizneseve sipas llojit jane: shitje (shumice dhe pakice), prodhim, sherbim dhe profesione te lira.

Nivelet treguese te takses orientohen sipas aneksit 5 te Ligji 9632 „Per sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, me te drejten per ndryshim -30/+10% nga organi legjislativ i bashkise.

Taksa mbi pasurine e paluajtshme

Taksas mbi pasurine e paluajtshme i nenshtrohen te gjithe personat fizike ose juridike, biznese dhe familjare, pronare te pasurive. Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nivelet treguese te taksas orientohen sipas aneksit 1 dhe 2 te Ligji 9632 „Per sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, me te drejten per ndryshim +/-30% nga organi legjislativ i bashkise.

Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja

Baza e taksas eshte vlera ne Leke e investimit te ri qe kerkohet te kryhet, ndersa niveli shprehet si perqindje e vleres se investimit dhe shlyhet nga investitori. E ardhura nga kjo takse mblidhet nga organi qe leshon lejen e ndertimit.

Taksa vjetore e mjeteve te perdorura te transportit rrugor

Detyrimi per kete takse llogaritet sipas Ligjit Nr. 9975, dt. 28. 07. 2008 “per Taksat Kombetare” i ndryshuar. Detyrimi per taksen i takon pronarit te mjetit sipas vendbanimit ose selise se tij. E ardhura nga taksa mblidhet nga strukturat e Drejtorise Rajonale te Sherbimeve te Transportit Rrugor.

Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme

Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme vendoset ne çastin e kalimit te se drejtes se pronesise bazuar ne siperfaqen e ndertimit te prones qe transferohet nga personi qe kalon te drejten e pronesise, dhe llogaritet nga zyrat e regjistrimit te pasurive te paluajtshme ne rolin e agjentit tatimor.

Taksa e fjetjes ne hotel

Baza e takses është çmimi i fjetjes, sipas rastit, për dhomë ose për person, për një natë. Niveli i takses është 5% e çmimit të fjetjes. Detyrimi për taksen i takon klientit që strehohet në hotel dhe mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë.

Taksa të tjera:

Taksa për zënie dhe hapësira publike për qëllime biznesi llogaritet si detyrim i detyrues dhe shprehet në meter katror sipërfaqe publike të zëna.

Taksa e tabelës ndahet sipas qëllimit të tabelës në:

-tabela për bizneset për qëllime identifikimi, të trëpëruar në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitetin, dhe kur nuk përdoret për të reklamuar aktivitetin e të tjerëve.

-tabela për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

2. Të ardhura jo tatimore

Të ardhura nga tarifimet vendore, siç janë tarifimet e pastrimit, ndriçimit, gjelberimit vilen në bazë të ligjit 8652, dt. 31. 07. 2000 „Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore“, dhe paguhen nga bizneset, institucionet e familjarët. Bashkia krijon të ardhura nga tarifimet vendore për shërbimet publike që ofron, si pastrim, gjelberim, ndriçim, duke u orientuar në përgjithësi në përfundimin e kostos së tyre.

Të ardhura të tjera jo tatimore, siç janë të ardhura nga veprimtaritë ekonomike, të ardhura nga shitja e pasurive kapitale të njesive vendore të lejuara me ligj, të ardhura nga qerata mbi trojet, ndërtesat dhe objektet e tjera vendore, të ardhura nga kontribute dhe sponsorizime të ndryshme, si ndihma, dhurime, sponsorizime, të ardhurat nga gjërat dhe kundërvajtjet administrative“, si dhe nga të ardhura të tjera.

Të ardhura nga institucione varesie të njesive të qeverisjes vendore, ku bëjnë pjesë pagesat për çerdhet, pagesat për kopshtet, pagesat e nxënësve të shkollave të mesme, pagesat nga konviktor me burse, gjysmë-burse si dhe të ardhura të tjera nga institucione vendore.

ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR VITIN 2013

Burimet e financimit të qeverisjes vendore përbëhen nga:

1. Të ardhurat e veta
 - Taksat vendore, Tarifimet, Të ardhura jo tatimore (të tjera, institucione në varesi të Bashkisë), Huatë.
2. Të ardhurat nga burime kombëtare, që ndahen në:
 - Transferta të pakushtëzuara
 - Transferta të kushtëzuara

TË ARDHURAT E BASHKISË DHE ELEMENTET NDIKUES

Te ardhurat e realizuara nga biznesi, duke përfshirë edhe takset e ndikimit në infrastrukture, zënë 50% të të ardhurave të veta, ndërsa së bashku me takset dhe tarifën familjare, duke përfshirë edhe parkimin për mjete personale, zënë rreth 75% të të ardhurave të Bashkisë Shkodër. Për këtë arsye është e rëndësishme për vijueshmërinë e mbare të buxhetit të Bashkisë Shkodër dhënia e rëndësise së duhur dhe trajtimit në mënyrë të veçantë të këtyre të ardhurave dhe kushteve për mbarevajtjen dhe vjeljen e tyre.

Te dhënat për taksapaguesit familjare përpunohen dhe administrohen nëpërmjet sistemit të kompjuterizuar të Ujësjetës Kanalizime Sh. A., që në rolin e agjentit tatimor bashkë me tarifën për shërbimin e ujit vjel edhe takset dhe tarifën familjare. Takset dhe tarifën arkëtohen në bazë mujore, dhe paguhën në çdo arke të Ujësjetës Kanalizime Sh. A të shpërndarë në qytetin e Shkodrës.

Për familjet me kryefamiljare pensioniste, status invaliditeti, me ndihmë ekonomike ose jetimi, që dorëzojnë dokumentacionin dhe plotësojnë kushtet sipas paketës fiskale të vitit 2013 është aplikuar lehtësia sociale, duke ndikuar për zbutjen e problemeve ekonomike të këtyre shtresave.

Në kuadrin e përmirësimit të klimes së biznesit në Shkodër, pranë Zyres me Një Ndalësë kryhet shërbimi ndaj tatimpaguesit, ku kryen informimin dhe rifreskimin me kuadrin ligjor dhe fiskal në fuqi për tatimpaguesit që kërkojnë informacion mbi legjislacionin dhe procedurat. Ky shërbim që nxit frymën e hapur dhe bashkëpunuese ndaj tatimpaguesve i ofrohet si bizneseve ashtu edhe familjareve.

Gjatë vitit 2013, në zbatim të ligjit Nr. 10 354, datë 18. 11. 2010, është mbyllur procesi i kompensimit të biznesit të vogël për shumën e rimbursueshme për takset vendore për vlerën e kasave fiskale me vlerë 1. 712 mijë Leke.

Në zbatimin e kuadrit ligjor, për uljen e evazionit fiskal, rritjen e konkurrencës së ndershme, me ndikim të drejtperdrejtë në rritjen e të ardhurave të bashkisë janë ndërmarrë një sërë aksionesh të Drejtorisë së të Ardhurave për goditjen e bizneseve të parregjistruara.

Nga Drejtoria e të Ardhurave është marrë inisiativa e krijimeve të grupeve të përbashkëta Task-Force, me përfshirjen e Inspektoreve të Drejtorisë Ardhurave, Policisë Bashkiake, Drejtorisë Rajonale Tatimore, Hetimit Tatimor dhe Policisë së Shtetit. Këto aksione u përqendruan kryesisht në periudhën Shkurt – Prill 2013, ku si rezultat i masave shtrenguese të ndërmarrë u realizuan 380 liçensime të reja.

Paralelisht në mënyrë të vazhdueshme janë monitoruar subjektet e mëdha për vendodhje të tjera të ushtrimit të aktivitetit, ku gjatë vitit është arritur rregjistrimi i mbi 50 adresave shtese.

Për rritjen e të ardhurave si dhe për trajtimin në mënyrë të barabartë të të gjithë bizneseve, janë ndjekur masa shtrenguese edhe për subjektet debitore. Pas përfundimit të afatëve ligjore për njoftim, Drejtoria e të Ardhurave ka ndjekur masat shtrenguese bllokim të aktivitetit, të


bllokimit të llogarive bankare dhe sekuestrim të mallit ndaj bizneseve debitore për takson biznesit të vogël dhe tarifën, si dhe për detyrimet e tjera si reklama, hapësira publike, parkingje të rezervuara etj.

Gjatë vitit 2013 janë ushtruar 650 kontrolle pranë bizneseve kryesisht në lidhje me dokumentacionin e mbajtur ligjor, xhiron vjetore dhe sipërfaqen e ndërtesave. Si rezultat i këtyre aksioneve janë bërë rreth 350 rivlerësime xhiroje dhe gjopa për mangësi në dokumentacion, si dhe janë verifikuar dhe rivlersuar rreth 150 subjekte për sipërfaqen e ndërtesës.


Strategjia e rritjes së të ardhurave si nga biznesi ashtu dhe nga familjarët shihet në shtrirjen e bazës së taksapaguesve dhe në saktësimin e të dhënave të subjekteve, gjë që realizohet nga Drejtoria e të Ardhurave dhe nëpërmjet bashkërendimit të punës me drejtoritë paralele të bashkisë dhe institucionet e tjera si Drejtoria Rajonale Tatimore, Zyra Regjistrimit Pasurive Paluajtshme, QKR etj.,

Agjenti tatimor që grumbullon të ardhurat për taksat dhe tarifën familjare është mbështetur nga Bashkia Shkodër kryesisht nëpërmjet sensibilizimit mediatik të taksapaguesve familjare, kontaktet nga afër me institucionet shtetërore për shlyerjen nga punonjësit buxhetorë të këtij detyrimi, deri në ndjekjen e masave shtrenguese si bllokimi i shërbimeve nëpërmjet administratave të bashkisë.

Struktura e bizneseve që ushtrjnë aktivitet në Bashkinë Shkodër është aktive dhe dinamike, falë politikave dhe strategjive lehtësuese dhe përsheptuese, që orientojnë tregun e lirë në gjithë shtrirjen e tij.



34 % ushtrjnë tregtim artikuj industriale



Shpërndarja sipas llojit të aktivitetit

- 25 % bar – kafe dhe restorante, hoteleri
- 17 % tregti konfeksione
- 11 % ushqimore
- 5 % subjekte ndertimi
- 8 % sherbime te tjera
















Te ardhurat e veta luajne nje rol te madh per sigurimin e burimeve financiare ne funksion te realizimit te misioneve te shumta te Bashkise ndaj qytetareve te saj. Burimet kryesore jane taksat dhe tarifat e bizneseve dhe familjeve.

Synimet kryesore jane fokusuar ne rritjen e bazes taksapaguese, rritjen e konkurrences se ndershme, goditjen e evazionit fiskal, uljen e numrit të subjekteve debitore, implementimin dhe zbatimin e ligjit dhe ndërtimin e marrëdhënieve te mira me taksapaguesit.

Ne te ardhurat e vitit 2013 kane pasur ndikim faktore te ndryshem, ku mund te permendet rritja e sensibilitetit te biznesit per perfshirjen ne skemen e tatimpaguesve te rregullt, rritja e ndergjegjesimit ne njohjen dhe zbatimin e ligjit, përqendrimi i administrates se bashkise ne detyrat e veta, si dhe bashkepunimi i mire ndersektorial dhe institucional brenda drejtorive te bashkise si dhe jashte saj me institucione te tjera te perfshira.

Zerat qe jane me tejkalim pozitiv realizimi dhe qe ndikojne ne realizimin total te te ardhurave si Taksa vendore e biznesit te vogel me 101% realizim, taksa e pasurise se paluajtshme nga biznesi me 101% realizim, taksa e kalimit te drejtes se pronesise me 149% realizim, tarifat e pastrimit nga biznesi me 118% realizim, tarifa e ndricimit nga biznesi me 110% realizim, tarifa e gjelberimit nga biznesi me 103% realizim, se bashku me te ardhurat nga kundravajtjet administrative, tarifat nga sherbimi i urbanistikes, tarifat e sherbimit nga Muzeu historik dhe te ardhura te tjera, me nje total prej 30. 000 mije Lekesh, mbulojne efektet ne te ardhurat totale te Bashkise Shkoder ne lidhje me planin qe rrjedhin nga disa zera si taksa e ndikimit ne infrastrukturë nga numri i vogel i kerkesave per leje ndertimi, nga te ardhurat e parashikuara nga familjaret, taksa per automjetet e perdorura qe vilet nga DRShTRr nga pergjysmimi me ligj i tarifes, zera keto qe ne vetvehte ndikohen nga faktore jashte institucionit te Bashkise Shkoder.

LLOJET E TE ARDHURAVE	Plani 2013	Realizimi pritsh. 2013	% Realizim
TE ARDHURAT E VETA GJITHSEJ	358,657	352,939	98%
Taksa Vendore mbi Biznesin e vogel	71,140	71,835	101%
Taksa e Pasurise se paluajtshme (ndertesa)	33,440	32,221	96%
<i>nga biznesi</i>	20,600	20,859	101%
<i>nga familje</i>	12,840	11,362	88%
Taksa fjetjes ne hotel	1,250	1,267	101%
Taksa ndikimit ne infrastrukture	50,000	43,397	87%
Taksa kalimit drejtes pronesisë	6,550	9,787	149%
Taksa e DRShTRr per mjetet e perdorura	56,000	38,151	68%
Takse zenie hapësira publike	3,700	3,701	100%
Takse table	355	342	96%
Taksa reklame	8,303	7,757	93%
Tarife vjetore per pastrimin,heqje mbeturina	58,607	60,251	103%
<i>nga biznesi</i>	28,307	33,283	118%
<i>nga familje</i>	30,300	26,969	89%
Tarife ndriçimi	15,722	14,280	91%
<i>nga biznesi</i>	3,602	3,950	110%
<i>nga familje</i>	12,120	10,330	85%
Tarife gjelberimi	10,388	10,328	99%
<i>nga biznesi</i>	4,328	4,447	103%
<i>nga familje</i>	6,060	5,881	97%
Tarife per leje sherbimi veterinar	1,500	679	45%
Tarife sherbimi parkim automjete	5,100	3,223	63%
<i>nga mjetet per biznes</i>	1,600	1,267	79%
<i>nga mjetet personale</i>	2,000	450	23%
<i>parking i rezervuar</i>	1,500	1,506	100%
Tarife liçensa transporti	505	1,003	199%
Tarife per liçense karburanti	1,100	400	36%
Tarife sherbimi per Urbanistiken	300	1,852	617%
Tarife per Legalizim,Urbanizim (ALUIZNI)	13,000	13,089	101%
Tarife sherbimi dublikate arkivi	85	67	79%
Tarife sherbimi nga Instituc kult & sport	3,100	2,163	70%
<i>Biblioteka</i>	0	0	
<i>Muzeu Historik</i>	1,500	1,603	107%
<i>Teatri Migjeni</i>	1,400	560	40%
<i>Qendra Kulturore Femijeve</i>	100	0	0%
<i>Stadiumi</i>	0	0	
<i>Pallati Sportit</i>	100	0	0%
Tarifa te tjera	0	0	
T e ardhura nga privatizimi	0	2,491	
T e ardhura nga qera	720	1,275	177%
<i>qera lokal</i>	720	944	131%
<i>qera truall</i>	0	331	
<i>qera tjera</i>	0	0	
T e ardhura nga shitje truall (mjeti)	0	0	
T e ardhura nga gjendja civile	200	73	37%





SHERBIMET PUBLIKE

A- REALIZIMI I SHERBIMEVE PUBLIKE PER VITIN 2013

1. Sherbimi i Pastrimit te Qytetit

Pasqyra e shpenzimeve sipas thesarit per sherbimin e pastrimit te qytetit ne mije leke

Nr	Emertimi	Plani 2013	Realizimi i pritshem 2013
1	Paga	1197	1197
2	Sigurime shoqerore	191	191
3	Shpenzime operative	97785	87641
4	Kosto depozitimi Landfillin-Bushat	560	560
	SHUMA	99733	89589

Shpenzimet per sherbimin e pastrimit ne buxhetin 2013 jane realizuar ne baze te kontrates se vjeter dhe kontrates se re me afat 5-vjeçar, e cila ka hyre ne fuqi me 1 Tetor 2013. Si me kontraten e vjeter ashtu edhe me të renë pati vazhdimesi ne sherbimet baze, por gjithashtu edhe permiresim cilesor te termave te kontratave te reja (per zonen jugore dhe veriore). Jane realizuar keto sherbime:

- “Mbledhje e transport mbeturina urbane” u realizua ne te gjithe qytetin. Çdo dite jane transportuar ne vend-depozitim mesatarisht 550 cope kazane mbetje dhe pastrimi i mbeturinave perreth tyre.
- “Menaxhimi i kazaneve” eshte kryer duke bere riparimin e herpashershem nga demtimet dhe lysterjen e tyre.
- “Fshirja e rrugeve” mekanike dhe me dorë eshte kryer cdo dite sipas siperfaqeve te hartuara ne grafik, ndersa nje pjese e siperfaqeve te rrugeve te percaktuara eshte mirembajtur çdo dite.
- “Larja e rrugeve” eshte kryer per 200 dite sipas grafikut te larjes se rrugeve 1 here ne dite dhe 2 here ne dite.

Kontrata e re me afat 5-vjeçar ka filluar me 1 Tetor 2013. Ne kete kontrate perfshihet zgjerimi i sherbimit te pastrimit te mbetjeve urbane dhe fshirjes rrugore, duke permiresuar gjithashtu menaxhimin dhe monitorimin e sherbimeve. Pervec permiresimit cilesor dhe sasior te sherbimeve baze, paraqet dhe inovacione ne mbrojtjen e metejshme te ambientit dhe reduktimin e kostove per kete sherbim:

- Riciklimi ka hedhur tashme hapa konkrete duke u bere i detyrueshem me kontrate duke filluar nga 3% (vlere qe zbritet nga kostoja totale e kontrates se re). Jane caktuar

dy pika grumbullimi ne qytet per mbetjet e riciklueshme (kryesisht plastike, karton dhe leter). Do te realizohet investimi per blerjen e 500 kazane te madhesive te ndryshme, nga te cilat 150 cope me kapacitet 1100 liter, 150 cope me kapacitet 240 liter dhe 200 cope me kapacitet 120 liter, dhe paisje mbrojtese per shkollat, bizneset dhe institucione te ndryshme. Parashikohet gjithashtu dhe nje fushate sensibilizuese e zgjatur me komunitetin dhe te gjithë grupet e interesit, dhe ne media mbi menyren se si do te funksionojë riciklimi.

- Me date 1 Nentor 2013 ka filluar shfrytezimi i landfillit Bushat ne zbatim te VKB nr. 99, date 01/11/2013. Eshte bere ristrukturimi i preventivit per diferencen e transportit me efektet financiare te miratuara ne VKB. Gjithashtu eshte parashikuar dhe kostoja e menaxhimit te mbetjeve me 1 euro (140 leke) per ton deri ne fund te vitit 2013 me vlere 560 mije leke. Me pas ne funksion te vendimeve te qeverise dhe entit rregullator te vendosjes se cmimeve, do kemi cmime fleksibel dhe me te arsyeshme.

Per periudhen 3-mujore Tetor-Dhjetor eshte parashikuar vlere paraprake prej 23. 730 mije leke, pasi fondi limit vjetor per tenderin e ri parashikohet 91. 570 mije leke.

2. Sherbimi i Mirembajtjes se Siperfaqeve te Gjelberta

Sherbimi i mirembajtjes se spierfaqeve te gjelberta kryhet me siper marrje, dhe viti 2013 eshte viti i pare i zbatimit te kontrates 5-vjeçare. Ne preventivat e hartuar per sherbimin e mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberta jane kryer keto sherbime:

- Sherbimi i mirembajtjes se lulishteve eshte kryer ne nje siperfaqe prej 66 mije m2, ku per cdo 1000 m2 lulishte perfshihen: bar i kultivuar 450 m2, siperfaqe lulesh 250 m2, siperfaqe rruge ne lulishte 300 m2 si dhe mirembajtje drure dekorativ, shkurre dekorative e bordure te gjelberta. Jane kryer sherbimet e plota edhe ne siperfaqet e rikonstruara vitet e fundit, me te gjithë elementet e saj. Pervec tyre ne siperfaqet e tjera te gjelberta qe nuk kane keto elemente jane kryer sherbime te pjesshme ne mirembajtje.
- Mirembajtje e drureve dekorativ, qe perfshin mirembajtjen e drureve dekorativ te gjelberimit rrugor, veç lulishtave. Ne preventivin e hartuar perfshihen proceset e krasitjes se tyre, vaditjes, prashitjes si dhe pleherimit per nje zhvillim sa me te mire. Sipas inventarit rezultojne 4020 drure dekorativ ne rruget kryesore te qytetit.
- Mirembajtja e shkurreve dekorative prej 800 cope perfshin mirembajtjen e shkurreve dekorative ne parterin e rruga “Mehmet Pashe Plaku”.
- Ne zerin “Mbjellja e drureve, shkurreve dhe bordurave te gjelberta” u parashikua dhe u krye zevendesimi i tyre nga tharjet dhe demtimet e pakthyeshme ne lulishta, si dhe plotesimi i gjelberimit rrugor.
- Ne zerin “Mirembajtje siperfaqe ujore” prej 650 m2 perfshihen punimet e mirembajtjes se shatervanit ne lulishten e Parruces, shatervani Sheshi Demokracia. Punimet qe perfshihen jane pastrimi, larja e tyre cdo muaj, si dhe riparimi i pompave dhe elektropompave ne raste te difekteve.

- Ne zerin “Mirembajtje shkurre dekorative” futen 250 cope ne vazo te medha te mbjellura me shkurre. Keto ndodhen kryesisht ne hyrjen e qytetit tone si dhe ne Pedonalen e Piacës. Ne preventiva eshte llogaritur prashitja, vaditja, mirembajtja e vazove si dhe ndonje zevendesim te bimeve te demtuara.

Realizimi i pritshem per keto sherbime parashikohet ne vleren prej 27. 710 mije lekesh.

Pasqyra e shpenzimeve sipas thesarit per sherbimin e mirembajtjes se siperfaqeve te gjelberta ne mije leke

Nr	Emertimi	Plani 2013	Realizimi i pritshem 2013
1	Paga	624	624
2	Sigurime shoqerore	100	100
3	Shpenzime operative	27710	27600
	SHUMA	28434	28324

3. Sherbimi i Mirembajtjes se Varrezave Publike dhe Deshmoreve

Realizimi i ketij sherbimi eshte kryer ne perputhje me preventivat me shpenzime te pergjithshme vjetore 5450 mije leke.

Pasqyra e shpenzimeve sipas thesarit per sherbimin e mirembajtjes se varrezave publike dhe deshmoreve ne mije lek

Nr	Emertim	Plani 2013	Realizimi i pritshem 2013
1	Paga	130	130
2	Shpenzime shoqerore	21	21
3	Shpenzime operative	5450	5356
	SHUMA	5601	5507

Realizimi i pritshem per vitin 2013 per kete sherbim eshte ne shumen 5356 mije leke. Gjate ketij viti jane realizuar sherbime cilesore sipas zerave te percaktuar ne kontrate per Mirembajtjen e Varrezave Publike dhe Deshmoreve, si dhe ruajtjen e tyre.

Gjate ketij viti jane realizuar punimet e shtimit te nje parcele me nga 300 vende. Nderkohe per nje ecuri me te mire te ketij sherbimi per vitin 2013 kerkohet perfundimi i shpronësimit te parcelave te planifikuara si dhe ndertimi i parcelave te reja per te mos krijuar probleme per vendet e varrimit ne dy vitet e ardhshme.

4. Mirembajtje rruge e trotuare ne qytet

Per vitin 2013 ky sherbim eshte kryer me sipermarrije me kontrate njevjeçare, me vlere te kontrates 6609 mije leke.

Pasqyra e shpenzimeve sipas thesarit per mirembajtje rruge e trotuare ne qytet ne mije leke

Nr	Emertimi i punimeve	Plani 2013	Realizimi i pritshem 2013
I	Shpenzime operative	7500	6609
	SHUMA	7500	6609

Gjate vitit 2013 u punua ne riparimin e rrugeve te demtuara me teper qe kane krijuar gropa te vogla ose qe eshte demtuar shtresa e asfalto-betonit. Ne keto raste eshte nderhyre ne mbylljen e gropave me te gjitha nenshtresat e shtresat asfaltike, si dhe ne riveshjen e nje pjese te rrugeve te demtuara si shtrese punuese.

Nje vemendje te vecante i eshte kushtuar edhe riparimit te trotuareve. Kryesisht eshte nderhyre ne trotuaret qe kane qene me amortizim me te madh ose qe kane pesuar demtime ose shembje te tyre.

Po ashtu eshte punuar ne ngritje dhe riparime te pusetave te demtuara ne rruge, si dhe riparimi i kunetave e bordurave.

5. *Mirembajtje KUB*

Pasqyra e shpenzimeve ne mirembajtje KUB ne mije leke

Nr	Emertimi i sherbimit	Plan 2013	Realizimi i pritshem 2013
1	Paga	3989	3989
2	Sigurime Shoqerore	635	635
3	Mallra e Sherbime te tjera	3000	2455
4	Trans. Buxh. Familjare & Individ	30	21
	SHUMA	7654	7100

Realizimi i sherbimit te mirembajtjes KUB per vitin 2013

Shpenzimet per mirembajtjen KUB ne buxhetin e vitit 2013 jane parashikuar vetem per 6-mujorin e pare te vitit. Me fondin e programuar Sh. a. UK ka perballuar mbulimin e shpenzimeve per paga dhe sigurime shoqerore per 6-mujorin e pare si dhe per mallra dhe sherbime.

Ne 6-mujorin e dyte, ne zbatim te VKB 168 date 28. 12. 2012, shpenzimet per paga, sigurime shoqerore dhe sherbime te tjera jane mbuluar nga burimet financiare te ndermarrjes UK.

6. Ndriçim rrugor

Pasqyra e shpenzimeve për ndriçimin rrugor në mijë leke

Nr	Emërtimi i shpenzimeve	Plani i vitit 2013	Realizimi i pritshëm 2013
600	Paga	3952	3952
601	Sigurime shoqërore	629	629
602	Shpenzime operative	43130	42656
606	Kompens. punonjësish	24	6
	Shuma	47735	47243

- Zërat **Paga** dhe **Sigurime Shoqërore** kanë qënë planifikuar **3 952 mijë** dhe **629 mijë** lekë.
- Zëri Shpenzime Operative përbëhej nga dy pjesë:

a. Materiale e shërbime speciale.

Për zërin Materiale e shërbime speciale kanë qënë planifikuar për t'u shpenzuar 2 630 000 lekë.

Ky shpenzim ishte parashikuar për blerjen e materialeve elektrike për **mirëmbajtjen** e infrastrukturës së ndriçimit ekzistues të qytetit me një sipërfaqe prej 531 000 m² rrugë, sheshe e lulishte.

Gjithsejt për zërin materiale e shërbime speciale realizimi i pritshëm për vitin 2013 është 2 155 752 leke. Janë kryer procedurat deri në furnizimin e mallit. Me këto shpenzime është siguruar baza materiale e nevojshme për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik.

b. Shërbime ku përfshihen kryesisht shpenzimet për energjinë elektrike.

Për zërin Shërbime, në të cilat ishin parashikuar shpenzimet për energjinë elektrike me shumë **40 500 000** lekë. Me fondin e programuar përballohet shlyerja e faturave të energjisë elektrike deri në fund të vitit 2013.

7. Sinjalistike – Dekor

Pasqyra e shpenzimeve për sinjalistikë - dekor në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i shpenzimit	Plani i vitit 2013	Plani i Pritshëm 2013
600	Paga	750	750
601	Sigurime Shoqërore	120	120
602	Shpenzime operative	2860	2557
	Shuma	3730	3427

1. Zërat **Paga** dhe **Sigurime Shoqërore** Për vitin 2013, kanë qenë planifikuar respektivisht **750 mijë** dhe **120 mijë lekë**. Realizimi i këtyre dy zërave për vitin 2013 ka qënë 437, 5 mijë dhe 70 mijë lekë.
2. Zëri **Shpenzime Operative**. Për vitin 2013 janë parashikuar **2 860 mijë lekë** të ndara në:
 - a. Sinjalistikë 2 280 mijë leke
 - b. Dekorim qyteti 580 mije leke

Gjithsejt për zërin materiale e shërbime speciale ”*Blerje materiale për sinjalistikën*”(horizontale + vertikale) realizimi i pritshëm për vitin 2013 është 1 977 240 lekë. Janë kryer procedurat dhe me këto shpenzime sigurohet baza materiale e nevojshme për mirëmbajtjen sinjalistikës horizontale (bojë rrugore) dhe sinjalistikës vertikale (tabela të llojeve të ndryshme, tuba etj).

Dekori i qytetit, gjatë këtij vitit 2013 realizohet blerja e bredhave për zbukurimin e qytetit për festat e fund vitit, gjithashtu dhe blerja e aksesorëve zbukurues ne shumen 580 000 lekë. Përveç këtyre shpenzimeve për zbukurimin e qytetit janë gjendje dhe aksesorët e blerë në vitet e kaluara që do të përdoren për këtë qëllim.

8. Mobiliteti (levizshmeria urbane)

Edhe gjate vitit 2013 Bashkia Shkoder eshte angazhuar mbi promovimin dhe mbrojtjen e kultures se pedalimit te qytetit te Shkodres brenda dhe jashte vendit.

Ne fillim te vitit Bashkia Shkoder fitoi konkursin mbi prezantimin e projekteve te realizuara nga bashkite dhe komunat e Qarqeve Shkoder dhe Lezhe organizuar nga dldp. Premioja ishte prej 5000 eurosh dhe u caktua qe te shpenzohet ne aktivitete mbi promovimin e mobilitetit te qendrushem shkodran. Kjo u nda ne tre aktivitete: Prezantimi i Shkodres ne

Konferencen “Walk21” ne Mynih te Gjermanise, Dita e Biçikletes dhe Aktivitet me biçikleta ne qarkun e Shkodres.

Ne Maj te ketij viti, bashkia Shkoder prezantoi kulturen e saj te pedalimit ne konferencen Europioane per Menaxhimin e Mobilitetit ECOMM, ne Gavle Suedi, ku morri dhe çmimin e pare me projektin MOBALB.

9. Transporti Urban

Gjate vitit 2013 sherbimi i transportit urban eshte kryer ne dy linja: Bahçallek-Fermentim-Bahçallek dhe Qender-Shiroke-Zogaj e kthim.

Sherbimi kryhet me operator privat ne vazhdim te zbatimit te kontrates qe ne shtator te vitit 2012. Operatori ka plotesuar numrin e nevojshem te planifikuar te automjeteve per kryerjen e ketij sherbimi me cilesi shume te mire duke krijuar kushte te mira per udhetim per te gjitha stinet e vitit.

Jane ushtruar kontrole te vazhdueshme dhe monitorime per te bere te mundur qe ky sherbim te jete sa me eficient dhe te plotesoje sa me mire kerkesat dhe nevojat e komunitetit si dhe te shohe mundesite e permireshimit te metejshem te ketij sherbimi.

Bashkia Shkoder ka realizuar sinjalistiken e nevojshme per te mbeshtetur realizimin e qarkullimit normal si dhe per informacion per oraret e levizjes etj.

Sherbimi gjate ketij viti, i cili eshte i pari qe kryhet me operator privat, eshte realizuar me te ardhurat e operatorit pa subvencion.

B. INVESTIME PUBLIKE

Realizimi i investimeve per vitin 2013

Shtese kontrate sistemim blloku pallateve Vau Dejes Lopçej me vlere 1 257 mije leke

Punimet ne kete objekt kane perfunduar ne fillim te vitit 2013, duke bere te mundur sistemimin e rrugeve ndermjet pallateve te ketij blloku me kanalizime te ujrave te bardha, kanalizime te ujrave te zeza, rrjetin e rikonstruktuar te ujesjellesit, ndertimin e trotuareve, pusetave, asfaltimin, etj..

Shtese kontrate sistemim blloku i pallateve Qaf Hardhi me vlere 711 mije leke

Punimet ne kete objekt kane perfunduar ne fillim te vitit 2013, duke bere te mundur sistemimin e rrugeve ndermjet pallateve te ketij blloku me kanalizime te ujrave te bardha, kanalizime te ujrave te zeza, rrjetin e rikonstruktuar te ujesjellesit, ndertimin e trotuareve, pusetave, asfaltimin, etj..

Restaurim i fasadave Gjuhadol me vlere te pergjitheshme 27 500 mije leke. Ky fond eshte pjesemarrje e Bashkise, me vlere **3 000 mije leke**, ne bashkefinansim me Banken

Nderkombetare per Rindertim dhe Zhvillim per “Projektin Lake Skadar-Shkoder Integrated Ecosystem Management Project”. Punimet kane perfunduar.

Zyra me nje ndalese me vlere **7 586 mije leke**. Realizimi i ketij investimi u be i mundur nga bashkepunimi i Bashkise Shkoder dhe DLDP. Bashkia Shkoder beri financimin ” me vlere **3 226 mije leke** per “Rikonstruksion e ndertim i zyres me nje ndalese qe sherbyen per realizimin e punimeve per rikonstruksionin e ambienteve te brendshme ne godinen e bashkise. Me donacionin nga DLDP eshte bere “Blerje dhe instalim pajisjesh per Intranetin e Bashkise Shkoder” me vlere **1 547 mije leke**, “Blerje paisjesh per zyren me nje ndalese” me vlere **1 197 mije leke** dhe “Mobilim paisje zyre” me vlere **1 616 mije leke**, etj.

Blerje tabela informacioni me vlere **150 mije leke**. Me kete fond eshte realizuar blerja e tabelave per plotesimin e sinjalistikes vertikale ne vendqendrimet e autobuzave urban.

Rikonstruksion fasada e hyrjes se pasme te Bashkise me vlere **480 mije leke**. Eshte realizuar fasada e Bashkise ne hyrjen nga mbrapa.

Rikonstruksion rruge dytesore me vlere **15. 701 mije leke**.

Me kete fond jane realizuar punimet ne gjashte rruge e blloqe pallate si:

- Sistemim **Rruga Djepaxhija (Stadiumi)**. Jane kryer punimet per asfaltimin e rruges, per ndertimin e pusetave dhe kunetave prej betoni per KUB.
- Sistemim Vazhdim rruga **Hysen Lohja**. Jane kryer punimet per asfaltimin e rruges, per ndertimin e pusetave dhe kunetave prej betoni per KUB.
- Rruga **Kadukej** prane shkolles Xheladin. Jane kryer punimet per asfaltimin e rruges, per ndertimin e pusetave dhe kunetave prej betoni per KUB.
- Sistemim rruga **Qukej**. Jane kryer punimet per asfaltimin e rruges, per ndertimin e pusetave dhe kunetave prej betoni per KUB.
- Sistemim blloku rruga **Tafilicaj**. Jane kryer punimet per asfaltimin e rruges, per ndertimin e pusetave dhe kunetave prej betoni per KUB.
- Sistemim rruga **Qafe Kala**. Jane kryer punimet per asfaltimin e rruges, per ndertimin e pusetave dhe kunetave prej betoni per KUB.

KUB dalje ne lumin Kir + dalja nr. 2 me vlere **15 261 mije leke**. Me kete fond jane realizuar dy daljet per largimin e ujrave te kolektorit te unazes lindore per derdhjen e tyre ne lumin Kir me kapacitetin e duhur.

Sistemim blloqe banimi me vlere 10 012 mije leke.

- Sistemim blloku rruga **Shaban Bushati**. Jane kryer punimet per asfaltimin e rruges, per ndertimin e pusetave dhe kunetave prej betoni per KUB.
- Sistemim blloku rruga **Dragushej**. Jane kryer punimet per asfaltimin e rruges, per ndertimin e pusetave dhe kunetave prej betoni per KUB.
- Sistemim blloku rruga **Kol Kamsi**. Jane kryer punimet per asfaltimin e rruges, per ndertimin e pusetave dhe kunetave prej betoni per KUB.
- Sistemim rruga **Bacej**. Ky objekt nuk eshte realizuar per arsye teknike pasi nuk kishte zgjidhje shkarkimi i ujrave te bardha. Punimet ne kete rruge do te realizohen gjate vitit 2014 se bashku me nje segment te kolektorit te rruges kryesore Ali Pashe Gucia dhe rruges Momini.

Rikonstrukcion lulishte para Bashkise me vlere 850 mije leke. Me kete fond eshte realizuar sistemimi dhe gjelberimi i lulishtes para Bashkise (rreth monumentit te Fishtes) si dhe shtrimi me pllaka guri ne sheshin ne krah te godines se Prefektures.

Hidroizolim i pallatit te sportit Qazim Dervishi me vlere 1 128 mije leke. Meqenese tarraca e pallatit te sportit ka patur probleme me lageshtine, ishte e domosdoshme hidroizolimi i saj, gje qe u realizua me kete fond.

Nga Fondi i Zhvillimit Rajoneve eshte bere prokurimi dhe lidhja e kontrates per realizimin e objektit **Rikonstrukcion i fasades se Radio Shkodres** me nje vlere **14 700 mije leke**. Me kete fond realizohen punime ne prishje e veshjes se pllakave, ne suvatime, veshje fasade me xham struktural, vetrata duralumini, etj. Punimet ne kete objekt vazhdojne edhe gjate vitit 2014.

Nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit eshte akorduar fondi prej **45 336 mije leke** per objektin **Riveshje asfalti dhe ndertim trotuari rruga "Industrial 1" qyteti Shkoder**. Ky objekt ka perfunduar. Ne kete rruge jane realizuar punimet e ndertimit te trotuareve dhe shtrimi te tyre me beton, kunetat dhe kasete e ujrave te bardha, asfaltimi, etj.. Pjese e rendesishme e investimeve ne kete zone, eshte realizimi i projektit te Ndertimit te Kanalizimeve te Ujrave te Zeza ne Zonen Industriale, nje projekt i Drejtorise se Pergjitheshme te Ujesjelles Kanalizime prane Ministrise se Puneve Publike ne Tirane me financim te perfituar nga Projektet IPA 2011 ne vleren rreth 700. 000 euro. Ne kete kuader me kerkese te Bashkise si edhe ne bashkepunim me Komisionin European u arriten te asfaltohen rreth 7000 m2 rruge me shtresa rrugore te qendrushme si Blloku i Pallateve ne rruga Gjovalin Gjadri / ish parku i mallrave/, rruga tek ish fabrika e vajit, rruga Treni i Mallrave, rruga Cerciz Topulli,

Ndertim Muzeu i Deshmise dhe Kujteses me vlere perfundimtare te zbatimi **58 941 mije leke**. Ne kete objekt punimet kane perfundur dhe eshte bere marrja ne dorezim.

Jane shlyer detyrimet e prapambetura nga vitet e meparshme te miratuara ne buxhetin e vitit 2013 per objektet si me poshte:

Rikonstruksion rruga”Musa Luli” me vlere **9 109 mije leke**

Sistemim trotuare rruge “Fahri Ramadani” me vlere **42 mije leke**

Riveshje asfalti e ndertim trotuari rruga “Industrial nr. 1” qyteti Shkoder me vlere **652 mije leke**

Rikonstruksion rruga Zooteknike - Shtepia e Bujqeve me vlere **1 270 mije leke**

Rikonstruksion i rruges se Kalase me vlere **930 mije leke**

Rikonstruksion rruga Karvanej me vlere **1 278 mije leke**

Rikonstruksion rruga 30 Korriku me vlere **2 000 mije leke**

INVESTIME NGA DONATORE PER VITIN 2013

Pedonale 13 dhjetori – 28 nentori me vlere te plote **70 000 mije leke**. Ky investim eshte bashkefinansim me Fondin Shqiptaro-Amerikan per Zhvillim ku Bashkia ka qene pjesemarrese ne bashkefinansim me vlere **28 000 mije leke**. Ne kete objekt jane realizuar punimet e infrastruktures nentokesore, shtrimi i gjith siperfaqes me pllaka guri dekorative, ndricimi dekorativ, vendosje stola e vazo dekorative.

Zgjerim dhe rikonstruksion rruga e Shirokes 115 979 mije leke. Me investim te Fondit Shqiptar te Zhvillimit vijojne punimet per kete objekt ku do te realizohet zgjerimi i rruges, asfaltimi i plote, krijimi i korsive per bicikleta dhe kembesor, gjelberimi, ndricimi etj.

Projekti “Furnizimi me Ujë dhe Mbrojtja Mjedisore e Liqenit të Shkodres”

Projekti “Furnizimi me Ujë dhe Mbrojtja Mjedisore e Liqenit të Shkodres” ka vijuar edhe gjate vitit 2013 per sigurimin e furnizimit me uje te pijshem si dhe permiresimin ne sistemin e kanalizimeve per ujerat e zeza dhe ujerat e bardha. Ky projekt eshte bashkefinansim i tre donatoreve te huaj dhe e Qeverise Shqiptare.

KFW	-	7.5 mil. Euro (Grant)
SECO	-	7.5 mil. Euro (Grant)
ADA	-	1.9 mil. Euro (Grant)
Qeveria Shqiptare	-	0.5 mil. Euro (Grant)

Aktivitetet e projektit:

1. Komponenti A - (Projektim i detajuar) Realizuar gjate vitit 2010

- Projektimi e detajuar me vleresimin e azhornuar te kostove
- Pregatitja e Dokumentave te tenderit

- Akordim i dy kontratave per zbatim

2. Komponenti C – (Fuqizimi Institucional) Realizuar gjate vitit 2010-2011

- Realizimi i blerjes se pajisjeve dhe programeve.
- Realizimi i trajnimeve te stafit te ndermarrjes.
Te gjitha programet jane perfituar dhe zbatohen ne punen e perditshme nga Stafi i ndermarrjes.

3. Komponenti B - (Furnizim dhe ndertim) Per zbatim gjate vitit 2011-2013

Objektet e realizuara deri ne vitin 2013

- Ne sektorin e Ujerave te Zeza

1. Furnizimi me mjete te specializuara per pastrimin e Ujerave te Perdorura (realizuar ne Qershor 2012)
2. Ndertim i rrjetit te KUZ ne fshatin Shiroke.
3. Ndertimi i rrjetit te KUZ ne fushen e puseve te ujit te pijshem ne Dobraq.
4. Ndertimi i Impiantit te trajtimit te ujerave te zeza.
5. Rehabilitimi i nje pjese te rrjetit KUZ ne qytetin e Shkodres.
6. Rehabilitim i Stacionit te pompimit te ujerave te zeza te qytetit.
(Punimet ne keto objekte jane ne proces)

- Ne sektorin e Ujesjellesit

1. Rehabilitimi i linjes kryesore te dergimit, punimet ne keto objekte vazhdojne.
2. Instalimi i ujematesave te medhenj.
3. Ndertimi i rezervuarit te ndermjetem te stacioni i pompimit te ujit te pijshem.
4. Rehabilitim i pjesshem i rrjetit te shperndarjes se ujit te pijshem (rrjet primar, sekondar dhe tercial)
5. Instalimi i matesave tek klientet familjare.



DREJTORIA PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Vizioni qe kemi per zhvillimin e qytetit na ka dhene hapësire te qarte ne veprimtarine e zhvillimit urban te qytetit dhe percaktimin e prioriteteve.

Ne baze te punes per realizimin e Zhvillimit Urban per vitin 2013 ka qene Plani i Zhvillimit Strategjik te qytetit te Shkodres per periudhen 2005-2015.

Ne zbatim te detyrave te veta Drejtoria e pergjitheshme e Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit te Territorit ka mbeshtetur punen e saj ne zbatim te Ligjit “ Per planifikimin e territorit “ nr 10119 date 23. 04. 2009 si edhe akteve te tjera nenligjore ne zbatim te tij.

Hyrja ne fuqi e ketij Ligji te ri si ne permbajtje edhe ne koncept ka sjelle disa veshtiresi ne menyren e zhvillimit te territorit dhe dhenien e lejave per kete zhvillim. Kompletimi i Ligjit me aktet e veta nenligjore te cilat mund te fillojne te hapin rrugen per dhenien e lejeve per zhvillim apo ndertim, perfundoi ne fund te vitit 2012. Drejtoria jone menjehere mbas ketij procesi u filloi punen per pergatitjen e materialeve qe do te duhen per te filluar proceduren e Lejeve te zhvillimit apo ndertimit.

Keshtu mbeshtetur ne aktet e mesiperme nenligjore u formuluan Dokumentat te cilat do te duhen per tu pajisur me Leje zhvillimi apo ndertimi per sicilin rast: ndertim i ri, shtese objekti, adoptim objekti, ndertim infrastrukture etj. U pergatit Udhezimi per menyren se si do te shqyrtohet nje kerkese si edhe afatet ligjore te shqyrtimit te saj. Eshte punuar faqja zyrtare e web (internetit) ku do te publikohen te gjitha kerkesat per Leje, te sejciles kerkese qe do te paraqitet. Ne kete menyre u pergatit infrastruktura e nevojshme qe me miratimin perfundimtar te Planit Territorial Vendor ne Keshillin Kombetar te Territorit te fillonte puna per zbatimin e tij.

Ky plan mori miratimin perfundimtar ne Keshillin Kombetar te Territorit me Vendim nr 14 date 4. 07. 2013.

Viti 2013 ishte nje vit relativisht i veshtire nga ana ekonomike siuate e cila u reflektua edhe ne fushen e ndertimit, sektor i cili ka ndjeshmeri te madhe ndaj siuates ekonomike. Megjithate nga ana jone per vitin 2013 jane dhene rreth 63 Leje Zhvillimor Ndertimi kryesisht objekte banimi nga 1 deri ne 3 kate dhe vetem 3 objekte 4 kat, 1 objekt 5 kat dhe 1 objekt 6 kat, kryesisht objekte banimi. Ne keto leje jane dhene edhe 3 Leje Infrastrukture dhe 1 leje per “ Ndertim Objekti i Prokurorise Shkoder”.

Gjithashtu jane dhene edhe 39 Leje perdorimi (shfrytezimi) objektesh duke filluar nga adoptimet e banesave dhe deri ne objektet shumekateshe.

Detyrimi yne ligjor ne funksion edhe te politikës se Bashkise Shkoder ne fushen e planifikimit te territorit ka rritur pergjegjesine ne menyre qe te administrojme ne menyre korrekte situaten ndertimore ne qytet e cila ka te beje me perdorimin racional te tokes.

INSPEKTORIATI NDERTIMOR URBANISTIK VENDOR

Ne zbatim te ligjit 9780, dt, 16. 07. 2007. "Per Inspektimin e Ndertimit"si dhe te Ligjit. Nr 8402 dt 10. 09. 1998, "Per Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve ne Ndertim"i ndryshuar Inspektoriati ndertimor urbanistik vendor, ka organizuar punen e tij.

Gjate vitit 2013, Inspektoriati ndertimor ka ndermarre nje sere nderhyrjesh per prishjen e nje numri te konsiderueshem objektesh te ndryshme, kryesisht per ti hapur rruge investimeve te ndryshme publike te bera nga Bashkia Shkoder, nga Drejtoria e pergjithshme e rrugeve si dhe nga donatore te ndryshem. Keto nderhyrje te Inspektoriatit sherbejne kryesisht per te liruar sa me shume hapësira publike per komunitetin dhe per ti hapur rruge zhvillimit te metejshem te infrastruktures se qytetit.

Gjate vitit 2013 eshte bere e mundur dhe prishja e te gjitha ndertimeve qe pengonin vazhdimin e punimeve ne Unazen Lindore te qytetit. Nje nder investimet me te medha dhe me te domosdoshem per qytetin tone. Megjithe veshtiresite e hasura gjate ushtrimit te detyres, duke pasur parasysh se qyteti ka nje shtrirje te madhe, dhe eshte nje qytet ne zhvillim sidomos ne fushen e ndertimit, nga ana e Inspektoriatit i eshte kushtuar nje vemendje e vecante fenomenit te parandalimit te ndertimeve ne fazat fillestare, si dhe kontrollit dhe disiplinimit te firmave te cilat operojne ne qytetin tone dhe jane pajisur me leje nga ana e Bashkise. Ne disa raste jane marre dhe masa Administrative ndaj ketyre subjekteve ndertuese.

Bashkepunimi:

Persa i perket bashkepunimit nga ana e Inspektoriatit eshte bashkepunuar mire dhe ne menyre korrekte me Njesite Administrative, kemi organizuar takime te herpashershme, me qellim marrjen e informacionit per parandalimin e ndertimeve pa leje.

Bashkepunimi me Inspektoriatin Ndertimor Urbanistik Kombetar. Nga ana jone eshte mbajtur korrespondenca me I. N. U. K per shumicen e praktikave te kryera nga I. N. U. V Bashkia Shkoder.

Me Drejtorine e Planifikimit dhe kontrollit te Zhvillimit te Territorit, eshte bashkepunuar mire sidomos ne kontrollin e objekteve te pajisura me leje ndertimi, per zbatimin korrekt te ketyre projekteve.

Me Z. R. P. P Shkoder, me qellim evidentimin e sakte te siperfaqeve ku jane ndertuar objekte te paligjshme, si dhe mos hipotekimin e objekteve me shkelje.

Drejtorine Rajonale te Monumenteve te Kultures, eshte bashkepunuar per parandalimin e ndertimeve sidomos ne zonat e mbrojtura.

Nje bashkepunim te mire kemi pasur dhe me Prokurorin e Rrethit Gjyqesor Shkoder. nga ana jone per vitin 2013 jane regjistruar 20 (njetzet) kallzime penale prane kesaj Prokurorie.

Bashkepunimi me Policine e Shtetit. Nga ana e Komisarariatit te Policise ka qene nje bashkepunim shume korrekte, duke na siguruar nje mbeshteje shume te mire ne te gjitha rastet e ekzekutimit te Vendimeve.

Pershkrimi i punes, treguesit, Statistikat dhe veshtiresite. Prane Inspektoriatit tone per gjate gjithe vitit 2013 ka pasur nje sere ankesash nga qytetare te ndryshem si dhe nga Institucione te ndryshme, nga ana jone jane verifikuar dhe jane kthyer pergjigje pjeses me te madhe te tyre.

Gjate vitit 2013 Inspektoriati ka bere nje sere nderhyrjesh(prishje objektesh) per lirimin e disa rrugeve dhe shesheve ne territorin e Bashkise per ti hapur rruge investimeve publike te bera kryesisht nga Bashkia Shkoder. Vlen te theksohet prishja e nje numri te konsiderueshem te ndertimeve, per ti hapur rruge perfundimisht punimeve per Unazen Lindore te qytetit, prishja e disa objekteve per ti hapur rruge punimeve per ndertimin e Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Shkoder, prishjen e disa mureve rrethuese te cilat pengonin asfaltimin e disa rrugicave te qytetit, etj.

Persa i perket veshtiresive, theksojme se megjithe numerin e vogel te punonjesve qe ka Inspektoriati ndertimor, (konkretisht ka vetem dy inspektore, dhe nje Kryeinspektor) e bejne te veshtire punen e Inspektoriatit per te ushtruar kontrollin e plote ne te gjitha territorin e Qytetit.

Treguesit dhe statistikat, Vendime te nxjerra dhe te zbatuara

Vendimet e dala	Nr	Zbatuar	Objekte te prishura
Vendime prishje te K/insp	8	6	6
Vendime te K. RR. T.	1	1	45
Vendime pezullimi	25	25	
Vendime per dhenie gjobe	41	21	

Vlera e masave Administrative te vendosura eshte 47. 597. 143 (dyzet e shtate milion e peseqind e nentedhjete e shtate mije e njeqind e katerdhjete e tre mije)Leke. Nga keto jane vjelur 18. 134. 222 Leke. Masa e tjera qe nuk jane paguar jane derguar prane sherbimit Permbarimor.

Persa i perket Vendimeve te prishjeve te nxjerra nga Kryeinspektori, dy nga keto nuk jane egzekutuar, pasi vazhdojne ne procese gjyqesore.

Gjithashtu nga ana e Inspektoriatit i eshte kushtuar nje vemendje edhe kontrollit te Subjekteve ndertuese qe operojne ne qytetin tone, jane ushtruar kontrole dhe sipas rasteve jane marre masa per pezullimin e punimeve ne objekt, si dhe jane vendosur sanksione Administrative aty ku jane verejtur shkelje.



DREJTORIA SHERBIMEVE SOCIALE, ARSIMIT, KULTURES, SPORTEVE, GRUAS

I. ZYRA E ARSIMIT

Realizimi i pritshëm për vitin 2013 për këto zyre paraqitet si më poshtë:

Ne 000/leke

NR	Emertimi	Plan 2013	I pritshmi 2013
1	Paga	33255	30852
2	Sigurime	5314	5027
3	Mallra dhe sherbime	36126	34374
4	Transferte korrente të brendshme	2520	2497
5	Transferta në buxhet familjare	199	169
6	Investime	3450	3367
	Shuma	80864	76286

A. Mallra dhe sherbime

Ne 000/ leke

Nr	Emertimi	Plan 2013	I pritshmi 2013
1	Materiale dhe sherb. zyre të përgjithshme	30	0
2	Materiale dhe sherbime speciale	12872	10023
3	Sherbim me të tretë	16242	18424
4	Shpenzime transporti	320	195
5	Shpenzime udhëtimi	0	0
6	Mirëmbajtje e zakonshme	3010	2131
7	Shpenzime të tjera operative	3652	3601
	Shuma	36126	34374

Shpenzimet janë realizuar si më poshtë:

Materiale e shpenzime speciale 10023 mijë leke ndahet:

*Punime skenë për festivalin e kenges për fëmijë, 605 mijë leke. *Blerje materiale të ndryshme elektrike, 250 mijë leke. *Blerje materiale të ndryshme hidraulike, 298 mijë leke. *Blere ene kuzhine, 100 mijë leke. *Blerje batanije për kopeshte me dreke, 100 mijë leke. *Blerje xham, 340 mijë leke. *Blerje materiale të ndryshme, 180 mijë leke. *Blerje bojra të ndryshme për lyerje të institucioneve, 150 mijë leke.

Shpenzime për ushqime, nga plani 9600 mijë leke, i pritshmi 8000 mijë leke.

Ne zerin sherbime me të tretë shuma prej 18424 mijë leke ndahet:

*Per energji elektrike, 7479 mije leke. *Per shpenzime konsum uji, 8468 mije leke.
*Shpenzime telefonise, 332 mije leke. *Shpenzime lende djegese (dru zjarri) 1918. mije leke. *Shpenzime per printime etj per festivalin, 145 mije leke *Shpenzime te tjera (dizinfektim kuzhina, magazina ushqimore, mensa etj), 82. mije leke.

Shpenzime per transportin (per dy automjete qe jane te amortizuara) 195 mije leke

*Blerje pjese kembimi 66 mije leke, *Siguracione 104 mije leke. *Shpenzime te ndryshme 25 mije leke.

Shpenzime per mirembajtje: 2 131 mije leke

*Vendosje aspiratore ne kuzhinat e kopshteve, 273. 6. mije leke. *Lyerje e pjesshme e fasades ne konviktin e shkolles Industriale (i vjetri), 144. 2 mije leke *Riparime te pjesshme ne shkollen N. Mazi, 114. 8 mije leke. *Riparime ne shkollen Speciale, 99. 7 mij leke *Lyerje te kuzhinave te kopshteve me dreke, 50. 1 mije leke. *Riparim kopshti I. S. Brucaj, 92. 5 mije leke *Riparime shkolla “ A. Hajdari”, 151 mije leke. *Riparime shkolla “I. Qemali”, 312. 6 mije leke. *Riparime tarace shkolla “ M. Camaj”, 350 mije. *Riparime kopshti “1 qershori”, 150. 2 mije *Ne dispozicion per emergjenca per nje hidrosanitare, 150 mije leke. *Riparime per automjetet, 92. 7 mije leke. *Riparime te paisjeve shkollore (tryeza, karrige etj), 149. 6 mije leke.

Shpenzime te tjera operative: 3601 mije leke e ndare:

*Siguracione ndertesash, 480 mije leke. *Honorare per aktivitete te Qendres Kulturore te femijeve per Aktivitetin Bilbilat e vegjel Kendojne, 510 mije leke, Veprimtari sportive, shkencore etj 260 mije leke, Festa e fundvitit, 692 mije leke.

*Shpenzime te tjera jane ndricimi per skenen e festivali 400 mije leke, akomodimi i pjesmarresve ne festival (ushqim dhe veshje) 702 mije leke, fonia e aktivitetit Bilbilat e vegjel kendojne 157 mije leke, shpenzime te planifikuar per pervjetorin jubilar te shkolles “I. Qemali” (ish shkolla Zdrate) 400 mije leke.

Transferata korrente te brendesheme: shuma 2497 mije leke e ndare:

*Shpenzime per Festivalin Mbarkombetare te Kenges per femije (krijimtari, cmime, juri), 2377 mije leke

*Shpenzime per Festen tradicionale per femijet e shkolles Speciale, 120 mije leke.

Shpenzime per investime: shuma 3367 mije leke e ndare:

*Rikonstrukcion i pjesshem i shkolles “Deshmoret e Prishtines”, 994. 6 mije leke.

*Rikonstrukcion i pjesshem i shkolles “Ndre Mjeda”, 1161. 5 mije leke,

*Shpenzime per supervizore dhe kolaudatore te objekteve te mesiperme, 63. 4 mije leke

*Shpenzime per shlyerjete e garancise se cilesise se punimeve te objekteve te kryera me pare, 297. 7 mije leke,

*Blerje paisje te ndryshme, ngrohesa me dru dhe me gaz, frigorifer, shporet gatimi e tj, ne shumen prej 469. 8 mije leke.

*Blerje paisje shkollore, per mensa etj ne shumen prej 380 mije leke.

II. DEGA EKONOMIKE KULTURES

Dega Ekonomike e Kultures trajton te gjitha marredheniet financiare te institucioneve kulturore te varesise qe jane: Muzeu Historik, Biblioteka Marin Barleti, Galeria e Arteve dhe Qendra Kulturore Pjeter Gaci.

Gjithashtu kjo dege ka trajtuar financiarisht edhe shpenzimet per aktivitete te ndryshme social – kulturore te planifikuara nga Zyra e Kultures si dhe shpenzime te tjera per aktivitete te ndryshme (shtese) te miratuara gjate vitit me VKB-se Shkoder.

A- Muzeu Historik

000/leke

Emertimi i shpenzimeve	Plani 2013	I pritshmi 2013
Paga	4, 635	4, 381
Sigurime shoqerore	782	732
Mallra dhe sherbime te tjera	1, 073	767
Transferime te brendshme	0	0
Transf. familjare dhe individ	56	44
Investime	600	366
Totali	7, 146	6, 290

Ne **Muzeun Historik**, shpenzimet per mallra e sherbime trajtohen si me poshte:

Materiale dhe sherbime zyre jane shpenzuar vetem 32 mije, nga 60 mije te parashikuara.

Materiale dhe sherbime speciale nga 150 mije te parashikuara nuk jane shpenzuar.

Sherbime nga te tretet jane parashikuar 511 mije leke dhe jane shpenzuar vetem 486 leke te shperndara: Energji Elektrike 200 mije leke,

Uje 40 mije leke,

Telefon 75 mije leke,

Shp. Postare 1 mije leke

Printime dhe Publikime 170 mije leke.

Per mirembajtjen e nderteses eshte shpenzuar 184 mije nga 200 mije leke te parashikuara

Shpenzime Operative te tjera (si Bileta etj) jane shpenzuar 65 mije nga 152 mije leke te parashikuara.

Zeri Investime sipas planit ishte parashikuar 600 mije leke, por eshte realizuar **366 mije leke** e ndare ne:

- Blerje dhe vendosje sistem alarmi, ne shumen prej 169 mije leke
- Blerje Scanner /Fotokopje, me shume 197 mije leke.

B- BIBLOTEKA

000/leke

Emertimi i shpenzimeve	Plani 2013	I pritshmi 2013
------------------------	------------	-----------------

Paga	6, 421	5, 950
Sigurime shoqerore	1. 073	1, 002
Mallra dhe sherbime te tjera	1, 225	745
Investime	2, 500	758
TOTALI	11, 219	8, 455

Ne **Bibloteken „Marin Barleti“** realizimi i shpenzimeve operative eshte **745 mije leke**.

Materiale dhe sherbime zyre jane parashikuar 70 mije leke dhe nuk jane realizuar.

Materiale dhe sherbime speciale nga 170 mije te parashikuara jane realizuar 40 mije leke.

Sherbime me te trete jane parashikuar 416 mije leke dhe jane realizuar 381 leke te ndare: energji elektrike 200 mije leke, uje 40 mije leke, telefon 60 mije leke, posta 1 mije leke tjera (interneti per sallen) 80 mije leke.

Mirembajtje e ndertes jane realizuar 205 mije nga 240 mije leke te parashikuara

Shpenzime Operative te tjera jane shpenzuar 119 mije leke e ndare: 29 mije leke per siguracion ndertese, 60 mije per honorare te aktiviteteve, 30 mije leke per shp. tjera operative.

Ne **zerin shpenzime per investime** ishte planifikuar shuma prej 2000 mije leke per blerje librash dhe jane realizuar 758 mije leke.

Shuma prej 500 mije leke per blerje vendosje kondicioneresh, fshese me korent dhe sistem alarmi nuk jane realizuar.

C- GALERIA ARTEVE

000/leke

Emertimi i shpenzimeve	Plani	I pritshmi
Paga	1, 160	1, 140
Sigurime shoqerore	194	190
Mallra dhe sherbime te tjera	1, 386	1, 426
Investime	460	60
TOTALI	3, 200	2, 816

Per Galerine e Arteve realizimi i shpenzime operative eshte si me poshte:

Materiale dhe sherbime speciale (katalog) nga 160 mije te parashikuara jane realizuar 143 mije leke.

Sherbime nga te tretet jane parashikuar 191 mije leke dhe jane shpenzuar vetem 176 leke te ndare: energji elektrike 80 mije leke, uje 25 mije leke, telefon 60 mije leke, postare 1 mije leke, te tjera(WEB page) 10 mije leke.

Shpenzime transporti u parashikuan 30 mije leke por nuk u shpenzua.

Ne **zerin mirembajtje e zakonshme** eshte shpenzuar 690 mije leke per rikonstruksionin e hyrjes se galerise dhe riparimin e tarraces te Galerise se Arteve.

Shpenzime Operative te tjera jane shpenzuar 416 mije nga 539 mije leke te parashikuara dhe konkretisht: 150 mije leke per honorare te aktiviteteve dhe 266 mije per shp. tjera operative.

Ne **zerin investime** u realizua blerja e aparatit fotografik profesional me shumen 60 mije leke.

D- QENDRA KULTURORE “ P. GACI”

000/leke

Emertimi i shpenzimeve	Plani 2013	I pritshmi 2013
Paga	2, 421	2, 373
Sigurime shoqerore	405	396
Mallra dhe sherbime te tjera	7, 260	6, 149
Investime	565	0
TOTALI	10, 651	8, 917

Per Qendren Kulturore shpenzime operative jane te shperndara sipas zerave te meposhtem: *Sherbime nga te tretet* jane parashikuar 161 mije leke dhe jane realizuar 136 mije leke te ndare: energji elektrike 60 mije leke, uje 25 mije leke, telefon 50 mije leke, postare 1 mije leke

Shpenzime trasnporti u parashikuan 350 mije leke por u shpenzua vetem 99 mije leke.

Shpenzime Operative te tjera jane shpenzuar 5 913 mije nga 6 749 mije leke te parashikuara te ndare:

- 5657 mije leke per honorare (honoraret per aktivitet e ketij institucioni gjate vitit ne shumen prej 465 mije, honoraret per Orkestres Frymore te Qytetit ne shumen prej 3675 mije, Orkerstren e Harqeve ne shumen prej 759 mije, dhe per grupet korale dhe te valleve ne shumen prej 759 mije lekesh).
- shp. tjera operative ne shumen prej 256 mije.

AKTIVITETE TE ZYRES KULTURES

000/leke

Emertimi i shpenzimeve	Plani 2013	I pritshmi 2013
Mallra dhe sherbime te tjera	4, 100	3, 686
Transferime korente te brend.	3, 250	2, 050
TOTALI	7, 350	5, 736

Jane realizuar keto **aktivitete**:

- **Aktiviteti „ Karvan Karneval 2013“** – u realizua 600 mije ne zerin transferime dhe 300 mije leke honorare.
- **Aktiviteti 6 Maji Dita e luleve.** – U realizua sipas parashikimit te bere: 400 mije leke ne honorare per artistet pjesmarres, 386 mije leke per shp. te ndryshme operative, dhe 600 mije leke si transferim.
- **Aktiviteti “Fesativali i muzikes moderne”** u realizua ne shumen 400 mije leke zeri honorare dhe 199 mije leke ne zerin shpenzime operative.
- **Aktiviteti “Dita boterore e Muzikes”**, u realizua ne shumen prej 200 mije leke ne zerin honorare.
- **Aktiviteti “Zhvillimi i sporteve te ujit”** u realizua ne shumen e 400 mije lekesh sipas VKB 59 dt 28. 05. 2013
- **Aktiviteti per Dita e lumturimit te Nane Terezes** u realizua ne shumen prej 200 mije leke ne zerin honorare.
- **Aktivitete per Festat e Nentorit** u realizua ne shumen prej 400 mije lekesh ne zerin honorare.
- **Aktiviteti „Ndermendje 2013“** u realizua shuma prej 900 mije leke jane honorare dhe 300 mije leke ne zerin shp. operative.
- Sipas VKB nr 46 date 26. 04. 2013 u realizua shperblimi per artistet Elhaida Dani 100 mije leke dhe Arilena Ara 50 mije leke.

III. TEATRI MIGJENI

000/leke

Emertimi i shpenzimeve	Plani 2013	I pritshmi 2013
Paga	16, 718	15, 821
Sigurime shoqerore	2, 659	2, 579
Sherbime nga te trete	800	788
Shpenzime transporti	300	0
Mirembajtje e zakonshme	500	0

Shpenzime te tjera operative	653	353
Honorare	2725	2.725
Investime	4.500	0
TOTALI	28,855	22,266

Per Teatrin „Migjeni“ shpenzimet e pritshme per vitin 2013 ndahen:

1. *Shpenzimet per paga* e sigurime ne shumen prej 18,400 mije leke
2. *Shpenzimet per mallra e sherbime* ne shumen prej 3,866 mije leke te ndara:
 - ✓ 788 mije leke sherbime per te trete
 - ✓ 353 mije leke shpenzime te tjera operative ku perfshihen 300 mije leke shpenzime pritje percjellje dhe 53 mije leke siguracion ndertese
 - ✓ 2,725 mije leke honorare nga te cilat:
 - 225 mije leke per anetaret e bordit artistik
 - Shpenzime per honorare per projektet artistike jane 2,500 mije te ndare si me poshte:
 - ✓ Komedia „Big Brodher shkodra 2’ ne shumen 1200 mije leke
 - ✓ Drama „Hana e janarit“, ne shume 200 mije leke
 - ✓ Drama „Provat gjenerale te nje vdekje te paralajmeruar“, ne shumen 200 mije leke
 - ✓ Komedia „Dashuri ne internet“, ne shumen 510 mije leke
 - ✓ Variete humor e muzike, ne shumen 390 mije leke.

IV. SPORT KLUB “VLLAZNIA”

000/leke

Emertimi i shpenzimeve	Plani 2013	I pritshmi 2013
Paga	8,739	7.854
Sigurime shoqerore	1,448	1,312
Mallra dhe sherbime te tjera	21,866	21,137
Transferime korente Boksi	900	900
Transf. buxhetet familjare dhe indivi	180	180

Investime	2, 923	2, 693
TOTALI	36, 056	34, 076

A- **Shpenzimet per mallra e sherbime** shuma prej 21, 137 mije leke, sipas planit, trajtohet ne tabelen me poshte:

000/leke

Emertimi i shpenzimeve	Plani 2013	I pritshmi 2013
Mat. dhe sherb. zyre dhe te pergjith	100	64
Materiale dhe sherbime speciale	16, 504	16, 324
Sherbime nga te trete	1, 309	938
Mirembajtje e zakonshme	100	33
Shpenzime te tjera operative	3, 853	3, 778
TOTALI	21, 866	21, 137

Zeri- Mallra dhe Sherbime- shpenzimet e realizuar per vitin 2013, ne total jane ne shumen prej 21137 mije leke qe mbulon shpenzimet per blerje mallra e sherbime, si dhe per aktivitetin sportiv te klubit, e cila ndahet:

- **Mallra e sherbime tjera** shuma **1. 035** mije leke trajtohet ne tabelen me poshte:

000/ leke

Shpenzime per materiale zyre	64
Shpenzime per sherbime per te trete	938
Shpenzime per mirembajtje e zakonshme	33
Shpenzime per siguracione	0
Shpenzim per blerje ilace	0
Shpenzime per udhetim dieta administrata	0

Shpenzime per aktivitetin sportiv - shuma prej **20. 102** mije leke, perfshin trajtimet ushqimore te sportisteve, pageset per honorare per trajnera, pagese honorare per gjygtareve etj, sipas klasifikimit bere nga Sport KlubVllaznia.

GRUPI A

a) Boksi, nje nder ekipet me rezultate me te mira. Ne kete sport jane pese ekipe (sipas moshave), te gjitha ne vendin e pare ne kampionate kombetare dhe nderkombetare. Shpenzimet per aktivitetin ne total shuma **3786 mije** leke e ndare: **2835 mije** leke shpenzime per trajtim ushqimor, **391 mije** leke pagesa per tre trajneret, **110 mije** leke materiale sportive, **150 mije** leke honorare per rezultate te larta, **300 mije** leke faze pregtitore,

b) Basketboll, M +F trajtohen gjashte ekipe, vende nderi ne kampionat kombetar e kane ekipet e te rinjeve dhe te rejave, ndersa ekipet e rritura M +F jane ne vendin e katert. Shpenzimet ne total per aktivitetin shuma prej **4502 mije** leke e ndare **3458 mije** leke trajtime ushqimore, **644 mije** leke pagesa per gjashte trajneret, **120 mije** leke materiale sportive, **60**

mije leke pagesa per gjygitaret e tavolines, **50 mije** leke per rezultate te larta sportive, **170 mije** leke, faze pregatitore grumbullim,

c) Volejboll, M + F trajtohen pese ekipe te cilet kane rrezultate te mira ne klasifikim Shpenzimet ne total **4472 mije** leke, e ndare; **3487 mije** leke shpenzime per trajtim ushqimor, **655 mije** leke pagesa per pese trajneret, **100 mije** leke materiale sportive, **60 mije** leke pagesa gjygitari i tavoline **170 mije** leke faze pergatitore grumbullimi.

d)Atletike, trajtohen ekipe zingjir te rritur, te rritura, te rinj te reja, nga ku per meshkuj renditen ne ved te pare. Shpenzimet ne total jane **2750 mije** leke, te ndara: **2275 mije** leke trajtim ushqimor, **475 mije** leke pagesa per gjashte trajnere,

e) Peshengritje, trajtohen tre ekipe, fituese te vendeve te kreut te renditjes, dhe ne Kampionate Nderkombetare. Shpenzimet ne total **2264 mije** leke te ndara: **1680 mije** leke trajtimi ushqimor, **414 mije** leke, pagesa per gjashte trajneret, **70 mije** leke materiale sportive, **100 mije** leke, honorare per rezultate te larta.

f) Gjymnastike, trajtohen gjashte ekipe, nga te cilet ekipi i te rriturave kampion kombetar. Ne muajin shtator eshte hapur akademia e gjymnastikes ne nje palester me qera, ku streviten ekipet zingjir te gjymnasteve djem dhe vajza. Shuma ne total **737 mije** leke nga te cilat **138 mije** leke pagese trajnereve tre trajnere, **599 mije** leke trajtim ushqimore.

GRUPI B

a) Mundje e lire, trajtohen tre ekipe (sipas moshave) fituese ne vendet treta e katerta. Shpenzimet per aktivitetin ne total jane **571 leke** te ndara: **385 mije** leke trajtime ushqimore, **186 mije** leke pagesa per dy trajneret,

b) Ciklizem, trajtohen dy ekipe, ku ne ekipin e te rinjeve kemi kampion kombetar dhe kampion Ballkanik. Shpenzimet per aktivitetin ne total jane **288 mije** leke te ndara: **150 mije** leke trajtime ushqimore, **138 mije** pagese per dy trajneret,

c) Shah, trajtohen dy ekipe, ekipi i te rriturve vendin pare Kampionat Kombetar. **163 mije** leke te ndara: **163 mije** leke pagesa per dy trajneret.

d) Judo, **230 mije** leke e ndare **115 mije** leke per trajtim ushqimor dhe **115 mije** leke per pagese trajneresh.

dh) Hendboll, jane dy ekipe ne Kampionatin kombetar te rinj vendi pare.

Shpenzimet per aktivitetin jane **94 mije** leke te ndara: **94 mije** leke pagese per dy trajneret.

e) Pingpong, jane kater ekipe, M + F te rritur dhe te rinj, fitues ne vende treta e katerta. Shpenzimet per aktivitetin jane **115 mije** leke te ndara: **115 mije** leke pagesa per nje trajner.

f) Not, trajtohen kater ekipe (sipas moshave) fituese ne vendet e katerta dhe e tete. Shpenzimet per aktivitetin jane **60 mije** leke te ndara: **60 mije** leke pagesa per trajneret.

Aktivitete tjera

Me rastin e perfundimit te vitit kalendarik, Sportklub “ **Vllaznia**” organizon aktivitetin festiv “ **Shpallja e sportistev me te mire te vitit**”.

Shpenzimet per kete aktivitete parashikohen ne shumen prej **70 mije** leke.

B- Investime -sipas planit fillestar shuma e planifikuar ishte 1623 mije leke, me VKB, nr 88, date 17. 10. 2013 “ndryshim zera shpenzimesh nga art 602 ne art 231 ”), u miratua shuma prej **1. 500 mije** leke per realizimin e aspirimit te pallatit sportit. Keto shpenzime trajtohen ne tabelen me poshte:

000/leke

Emertimi i shpenzimeve	Plani 2013	I pritshmi 2013
Rikonstruksion i pjeshem i pallatit	878	728
Blerje dhe vendosje prozhektoresh	465	465
Blerje paisje kompjuterike	50	0
Blerje rafte e tavolina per pallatin	30	0
Blerje dhe vendosje paisje aspirimi	1500	1500
Totali	2923	2693

V. KLUBI FUTBOLLIT K. F VLLAZNIA sh. a

Buxheti e KF VLLAZNIA sh. a akorduar nga Bashkia Shkoder eshte realizuar si me poshte:

Gjate vitit 2013 jane akorduar fondet si me poshte:

VKB Nr. 172, datë 28. 12. 2012 = 20, 000, 000 Leke

VKB Nr. 2, datë 30. 01. 2013 = 10, 000, 000 Leke

VKB Nr. 48, datë 26. 04. 2013 = 2, 000, 000 Leke

VKB nr.100 date 11.11.2013 = 4, 500, 000 Leke

TOTALI = 36, 500, 000 Leke

Me keto fonde jane realizuar shpenzimet si me poshte:

Shpenzime kontratash:

- Paga të lojtarëve	24, 390, 341 lekë
- Paga të trajnerëve	2, 612, 265 lekë
- Paga të Administratës	4,804, 546 lekë
- Paga të Akademisë	1, 759, 000 lekë
- Paga të Doktorave	899, 100 lekë
- Paga Futsalle	317, 500 lekë
- Taksa+TAP+Sig.	1, 423, 122 lekë
- Transport	360, 000 leke
Totali	36, 565, 874 lekë

VI. SHERBIMET SOCIALE

Pasqyra aktiviteti sipas zerave te shpenzimeve

000/lek

Nr	Lloji i sherbimit	Plani 2013	Fakti 2013
1.	Sherbime komunitare M. Lulaj, Kiras	60	0
	-energji elektrike	48	36
	- uje	240	0
	-aktivitete		
2.	Sherb. Komunitare familje/gra femije	384	0
3.	Sherbime komunitare per te moshuar	384	0
4.	Sherbimi Anti-dhune	42	
5.	Sherbimi i CPU	130	
6.	Plani Social	100	0
Totali		1380	36

Nga fondi kontigjences me VKB, nr 86, date 30. 9. 2013 jane akorduar 280 mije leke shperblim per jetimet (606).

Sherbimi social per vitin 2013 eshte planifikuar te realizohet ne mbeshtetje te Planit Social te Zones, te miratuar nga Keshilli i Bashkise ne vitin 2008. Ne baze te ketij instrumenti, fokusohen sherbimet sipas target-grupeve te parashikuara: femije, gra dhe te moshuar me prioritet sherbime sociale alternative per keto kategori sipas problematikave qe secili prej tyre paraqet.

Nga sherbimet e ofruara ne zyre kane perfituar shume kliente te cilet i jane drejtuar Zyres se Sherbimeve Sociale. Me konkretisht shpjegohet me poshte:

Komisioni i Vleresimit te Nevojave per vitin 2013 ka marre 3 vendime per sistemim te qytetareve, te cilet i jane drejtuar Zyres se Sherbimeve Sociale, per sistemim ne nje nga Institucionet Rezidenciale. Gjithashtu ne zbatim te ligjit nr. 89, datë 26. 1. 2012, ne vitin 2013 eshte ngritur Komisioni Multidisiplinar per Vendimet e Kujdestarise, dhe deri tani ky Komision ka marre 2 vendime.

Zyra per Mbrojtjen e Femijeve, si cdo vit tjetër, ka evidentuar rastet e dhunes, shfrytezimit dhe neglizhimit te femijeve dhe ka koordinuar veprimet me aktoret publike dhe private te fushes sociale per lehtesimin apo zgjidhjen e rasteve te evidentuara. Gjate vitit 2013, eshte mbledhur 3 here Grupi Multidisiplinar per 3 raste emergjente qe kane patur nevojë per koordinim pune mes te gjithë aktoreve te ketij grupi. Zyra per Mbrojtjen e Femijeve, per vitin 2013 ka trajtuar 65 raste.

Me daten 20 Nentor, eshte Dita Nderkombetare e te Drejtave te Femijeve dhe zyra ka organizuar nje aktivitet ne bashkepunim me institucione publike dhe private.

Zyra per barazine gjinore dhe kunder dhunes ne familje ka ofruar sherbimin per evidentimin dhe masat mbrojtese ndaj viktimave te dhunes ne familje. Kete vit, ky sherbim me se tepermi eshte ofruar ne takime te drejtperdrejta. Grupi teknik i punes per rastet e dhunes ne familje eshte mbledhur cdo 4 muaj, dhe eshte diskutuar per rastet me eksteme te cilat kane patur nevojte per nderhyrje emergjente ka secili prej anetareve te grupit teknik te dhunes ne familje. Gjate vitit 2013, bashkepunimi ka qene me se shumti me Drejtorine e Policise se Qarkut Shkoder, Gjykatën e Rrethit Gjyqesor dhe organizatat qe veprojnë ne qytetin e Shkoderes. Per vitin 2013 jane zbatuar 43 vendime te gjykates (urdhera mbrojtje dhe urdhera te menjehershme mbrojtje) dhe jane trajtuar 30 raste dhune ne familje.

Ne datat 25 nentor – 10 dhjetor jane 16 ditet e aktivizmit kunder dhunes ne familje dhe zyra per keto dite ka zhvilluar nje sere aktivitetesh.

Projekti Shpresa- sipas kontates te lidhur mes Bashkise Shkoder dhe Projektit “Shpresa” me nr. prot. 703 date 18. 02 2013 “ **Per percaktimin e fondit dhe proceduren e levrimit te tij per pagat e personelit sherbyes per projektin Shpresa**” neni 2, sipas te cilit bashkia merr persiper sigurimin e fondit prej 11, 000 mije leke per paga e sigurime te 24 punonjesve qe ofrojne sherbime ne 7 komunitete rezidenciale (Shtepi – Familje) qe ndodhen ne territorin e Bashkise Shkoder, nga te cilet jane 24 kujdestarë që kryejnë shërbim në 24 orë në bazë të turneve të përcaktuara dhe rregullores së brendshme të Shtëpi-Familje. Gjate vitit 2013 nga ky fond jane shpenzuar **10, 797, 870** leke.

000/leke

Periudha	Paga	Sig. shoq	T. A. P	Totali
Janar - Dhjetor	7, 350	2, 581	865	10, 797

Fokus grupet perfituese te sherbimeve ne keto shtepi - familje jane:

59 fëmijë, e të rinj e të reja, të privuar nga referimet familjare, me paaftësi psiko-fizike dhe shqisore, të deinstitutionalizuar nga Qendrat Psikiatrike Shtetërore dhe Jetimore e rretheve të ndryshme të Shqipërisë të mirëpritur në Shtëpi-Familje ku kanë gjetur një përgjigje globale të nevojave të tyre dhe në veçanti janë shoqëruar në udhëtimin e tyre drejt autonomisë dhe integritit në Shoqërinë Civile.

Rezultatet socio- edukative ne 7 Komunitete Rezidenciale (Shtëpi-Familje) që mikpresin 60 fëmijë, të rinj dhe të reja të ndarë për nga gjinia, mosha, patologjia.

Është ndjekur një ecuri edukative-riabilitative e diferencuar sipas projekteve individuale dhe standarteve të përkujdesjes sociale (ekipi multidisiplinar); Koordinator i përgjithshëm për Shtëpi-Familje, Psikologe klinike, Psikiatër, Neuropsikiatër, Mjeku i familjes, kujdestarët socialë, duke ndjekur, trajtuar dhe verifikuar etapat e ecurisë nëpërmjet takimeve periodike.

VII. ÇERDHE

Viti 2013	Totali	Paga	Sigurime	Mallra e Sherbime	Investime	Transfertat per individ
Plani	27. 003	16. 562	2. 642	6. 610	1. 090	99
Realizimi 2013	26. 272	16. 200	2. 581	6. 535	857	99

1. Ne zerin e pagave eshte realizuar ne vleren **16. 200 mije leke**.
2. Ne zerin e sigurimeve eshte realizuar ne vleren **2. 581 mije lekë**.
3. Ne zerin “Mallra dhe sherbime te tjera” plani eshte **6. 610 mije leke** ndersa realizimi eshte ne vleren **6. 535 mije leke**.
 - Ne zerin “Materiale dhe sherbime speciale “ eshte realizuar ne vleren **4. 118 mije leke**, qe perfaqeson:
 1. Shpenzime per ushqime ne shumen **3. 768 mije leke**
 2. Shpenzime per blerje te materjaleve te ndryshme si: (ene guzhine, carcafe etj ne shumen prej **350 mije leke**
 - Ne zerin “Sherbime nga te trete” realizimi eshte ne vleren **1. 696 mije leke** e ndare:
 1. Shpenzimet per energji elektrike qe perfshijne vleren **605 mije leke**
 2. Shpenzimet e konsumit te ujit me vlere **825 mije leke**
 3. Blerje lende djegese (dru zjarri) **266 mije leke**
 - Ne zerin „Mirëmbajtje te zakonshme realizimi eshte ne vleren **481 mije leke** e ndare:
 1. Shuma prej **391 mije mirembajtje** ndertesa
 2. Shuma prej **60 mije mirembajtje** pajisje teknike
 3. Shuma prej **30 mije leke** pajisje zyre
 - Në zerin Qera objekti realizimi eshte **240 mijë lekë** sipas planifikimit per pagese qeraje per çerdhen 10 Korriku.
4. Ne zerin „Transferta per individ“ realizimi eshte **99 mije leke**.
5. Ne zerin “Investime” plani eshte **1090 mijë lekë** për vitin 2013, ndersa realizimi eshte **857 mijë leke** e ndare:
 - Shuma prej **318 mije leke** qe përfaqëson investimin e bërë për rikonstruksionin e çerdhes “ 1 Qershori” te rrethimit me kangjella te oborrit ta saj
 - Shuma prej **280 mije leke** qe perfaqson rikonstruksionin e bere tek Çerdhja “M. Alimani” per suvatimin nga jashte te nderteses dhe shtrim pllaka ne ambjente brenda.
 - Shuma prej **119 mije leke** eshte shpenzuar per ndarjen e magazines ushqimore me vetrate.
 - Shuma prej **140 mije leke** eshte shpenzuar per “Blerje paisje”si: (frigorifere, shporet me gaz per gatim, ngrohesa uji, ngrohës me gaz).

Shuma totale e realizimit te buxhetit te vitit 2013 eshte **26. 272 mije Leke**.



Drejtoria e Promovim Zhvillimit, Statistikave dhe Z1N &
Drejtoria e Koordinimit Projekteve dhe MarRdhenieve
Nderkombetare.

I. Projekte ne kuader te programit IPA Adriatik dhe IPA Shqiperi Mali i Zi

1. PROJEKTI ADRIA MUZE

Objektivat kryesore te projektit jane forcimi i maredhenjeve në mes te partnereve dhe perkrahja për zhvillimin e rajonit te Adriatikut. Qellimi është qe te realizohet harmonizimi i aktiviteteve te partnereve ne lemin e turizmit kulturor dhe fokusi eshte ne ngritjen e interesit mbi Muzeumet ne rajon. Prandaj planifikohet një afrueshmeri e Muzeumeve duke vene ne

veprim ne Euromuse. net, hapsire ekspozuese nderkombetare ku i bashkon informatat per Muzeumet me te rendesishme dhe ekspozitat ne Europe dhe organizon shume ngjarje te cilat mund te lidhen Muzeumet Adriatike dhe te jene me afer nje rrethi me te gjere te vizitoreve. Ne kete gjurme eshte edhe transformimi i Muzeumeve ne qendra kulturore plot jete, e cila eshte nje prej qellimeve kryesore te projektit AdriaMuse.

Aktivitetet kryesore te projektit jane realizimi i projektit pilot me Venezian dhe shkembimin e eksperiencave.

Gjate vitit 2013 jane realizuar keto aktivitete kryesore:

-Shkurt 2013... Vizite pune ne Venecia ne lidhje me bashkerendimin e puneve per aktivitetin e perbashket pilot ne dy qytetet tona per traditen e lundrimit.

-Prill 2013... Konferenca e 5-te Transnacionale e partnereve ne Campobasso, Itali. Diskutime dhe dhenje llogari per ecurine e projektit dhe problemeve financiare te tij.

- Fund Prilli 2013... Seminari me teme: "Eventet pertej mureve te muzeumit". Aktivitet i gjere dhe gjithperfishires kulturor, turistik dhe promovues i projektit AdriaMuse.

-Shtator 2013... Skenarizimi dhe regjistrimi i nje video promocionale per projektin AdriaMuse, derguar partnerit nga Istria, Kroaci.

2. LEGEND

LEGEND eshte nje projekt i BE-se (Bashkimit European) i bashkefinancuar nga Programi IPA Adriatik CBC. Objektivi i tij i pergjithshem eshte promovimi i koncepteve te eficiencës së energjisë gjeotermike dhe benefiteve te energjise me entalpi te ulët në zonën e Adriatikut.

Aktivitetet e realizuara gjate vitit 2013

1. Kick off meeting per prezantimin e projektit.
2. Konkurs mes shkollave te mesme per njohurite ne lidhje me energjine termike.

3. MARUBI

Objektivi i pergjithshem i projektit eshte promovimi i bashkepunimit nderkufitar me synim rritjen e vlerave te perbashketa kulturore ne vecanti te pasuruse se Marubeve dhe potencialet mjedisore te zones se Shkodres dhe Ulqinit. Permiresimi i ketyre potencialeve synon te promovoje zhvillimin ekonomik ne te dy anet e kufirit.

Aktivitetet e realizuara gjate vitit 2013.

- Krijimi i newsletter Marubi (edicioni 1 dhe 2).
- Trajnimi i mediatoreve te trashegimise kulturore permes nje kursi 2 javor me ekspertet me te mire te turizmit ne vend.
- Realizimi i Marubi Route.
- Realizimi i webpage te projektit

4. EURO MIGMOB.

Euro MigMob është një projekt i financuar në kuadër të programit Europe For Citizens i BE. Ka në fokus të tij shkëmbimin e eksperiencave mes partnerëve në fushën e mobilitetit migrator në Europë. Projekti është aplikuar dhe fituar nga Bashkia Shkodër e cila ka 23 partnerë komuna, bashki, dhe organizata nga Italia, Franca, Kroacia, Hungaria etj.

II. Projekte me Programin e zhvillimit Rajonal – Shqipëria e veriut

Bashkia Shkodër, në kuadër të Programit Zhvillimi Rajonal i Shqipërisë së Veriut, aplikimet për dritaren 1, pjesa B, ka aplikuar dhe është shpallur fitues me projektin me titull **“Ndertimi i sistemit të ndriçimit të rruges “Ura e Bunes – Shiroke” me vlefte prej 109, 493. 23. Euro.**

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është përmirësimi i kushteve të jetesës së banorëve të zonës Shiroke Zogaj duke kontribuar në zhvillimin e tyre social ekonomik. Ndërsa objektivi specifik është përmirësimi i aseteve turistike të zonës nëpërmjet ndertimit të sistemit të ndriçimit publik të rruges Ura e Bunes – Shiroke.

Në kuadër të po këtij programi por për aplikimet e dritares 2, pjesa B, Bashkia Shkodër hartoi dhe aplikoi me projektin me titull **“Zhvillimi i turizmit mjedisor në lumin Buna dhe liqenin Shkodër” me vlefte 124, 959. 6 Euro.** Ky projekt, i cili konkuronte me shumë projekte të tjera të aplikuara nga njësi të qeverisjes vendore dhe organizata të tjera, u shpall projekt fitues.

Objektivat specifik të këtij projekti janë:

1. Promovimi i zonës si destinacion turistik dhe ndergjegjësimi i komunitetit për mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit të liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna.
2. Pastrimi i bregut të lumit Buna dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës (Nga qendra Zogaj deri në qendër Oblike)
3. Rehabilitimi i infrastrukturës së plazheve të vogla përgjatë bregut perëndimor të liqenit dhe zhvillimi dhe instalimi i infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e sporteve ujore dhe aktiviteteve të notit në liqenin e Shkodrës.

II. Programe në kuadër të bashkëpunimit me donatore të ndryshëm

1. DLDP – Programi për Zhvillim Lokal e Decentralizim Projekti Zyra me një Ndalese

Ky projekt është iniciativë e parë e kësaj permase të realizuar nga Bashkia dhe një ndër projektet me të rëndësishme për institucionin tonë.

Në kuadër të këtij projekti në kemi realizuar:

Ndertimin e Zyres me një ndalese në Bashkinë Shkodër si qendër shërbimesh ndaj qytetarëve dhe biznesit me infrastrukturën fizike dhe të logjistikës së nevojshme për funksionimin e ZIN, si dhe Sistemin IT funksional dhe të pajisur me infrastrukturën e nevojshme Hardware dhe Software për dixhitalizimin e proceseve të punës për administratën e bashkisë.

Ngritja e zyrës me një ndalesë ku qytetarët do të kenë mundësi të marrin nga një zyrë e vetme dhe e posaçme kontakti brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme të gjithë

informacionin, dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e nevojave të qytetarëve do të ndikojë në përmirësimin e informimit dhe komunikimit të Bashkise Shkoder me qytetaret e saj dhe biznesin duke rritur transparencën dhe efektivitetin e administrimit dhe funksionimit të Bashkise.

Hapja e kesaj qendre dhe instalimi i nje infrastrukture elektronike bashkekore eshte guri i themelit te qeverisjes elektronike ne Bashkine Shkoder. Ngritja e qendres sherbeu si pikenisje e nje reforme te madhe ne modernizmin e qeverise dhe marredhenjeve mes qendres dhe drejtorive te bashkise, duke mundesuar afrimin e Bashkise Shkoder me standartet e avancuar te qeverisjes vendore.

Ky projekt ofron garancine per sherbime administrative cilesore per komunitetin, qasje te shpejte ndaj informacionit dhe sherbimeve, pritje e komunikim me sjellje etike dhe miqesore, ndaj publikut, modernizim te menaxhimit te puneve te administrates, transparence ne vendimarrjen bashkiake.

Ne kuader te ketij projekti dhe te instalimit te qeverise elektonike Bashkia ka ngritur dhe vene ne funksionim nje infrastrukture te teknologjise se informacionit e cila i mundeson administrates se bashkise dhe publikut nje komunikimi modern dhe efektiv ne ofrimin e sherbimeve dhe fuqizimin e demokracise vendore.

Qytetaret dhe bizneset do te kene mundesine qe nepermjet kesaj qendre te marrin sherbime te informimit, zhvillimit te territori, sherbimet sociale, keshillime juridike, taksat dhe tarifat, sherbimet publike dhe vendimarrjen e bashkise.

2. Fondacioni Shqiptaro Amerikan per Zhvillim (AADF)

Krijimi i zones se permiresimit te Biznesit rruga “28 Nentori”.

Bashkia Shkoder dhe Fondacionit Shqiptaro Amerikan, ne zbatim te marreveshjes ndermjet tyre, per zhvillimin e projektit “Zona per Zhvillimin e Biznesit” te rruges “13 Dhjetori dhe 28 Nentori”, jane vene ne dizpozicion zyra ne mjediset e bashkise per mirefunksionimin e aktiviteteve te kesaj shoqate si dhe eshte realizuar transferimi per llogari te shoqates vlefte e arketimeve nga tarifat e mbledhura te bizneseve anetare te kesaj shoqate.

3. SEENET

Gjate vitit 2013 eshte alokuar fondi i parashikuar prej 62 836, 58 Euro per vitin 2013 prej 95 036, 58 Euro te parashikuara gjithsej per te tre vitet. Me kete shume jane realizuar nderhyrje rikualifikuese ne mjediset publike ne Zogaj dhe jane ne fazen e realizimit dokumentari promocional per qytetin e Shkodres dhe Liqenin Shkodres.

III. Aktivitetet promocionale

Dita e liqenit

Me date 16 qershor 2013, me qender lagjen Shiroke, Bashkia Shkoder organizoi aktivitetin festiv " Dita e liqenit". Gjate kesaj dite u organizuan nje sere aktivitetesh sportive ujqore, si maratone noti, aktivite sportive me veliera, kanoe, windserf etj. Gjithashtu u zhvillua edhe panairi i artizanatit dhe i produkteve agroushqimore te zones dhe ne mbremje festa kulmoi me nje koncert festiv me pjesmarrjen e grupeve muzikore rinore te qytetit.

Ne aktivitetet sportive u jore pervec pjesmarres se ekipeve te notit te Klubit Shume Sportesh te Vllaznise muaren pjese edhe ekipe nga Tirana dhe Durresi. Vlene te theksohet se kete vit gjeografia e pjesmarresve ne aktivitetet e festes se liqenit u zgjerua edhe me shume me pjesmarrjen e ekipeve nga Kosova dhe Dibra e Madhe e Maqedonise.

Panairi turizmit me titull “Shkodra, Tradite, Kulture, Histori

Ne kuader te aktiviteve te organizuara me rastin e pervjetorit te themelimit te Fakulteti Ekonomik te Universitetit te Shkodres “Luigj Gurakuqi”, u organizua nje panair turizmi me titull “Shkodra, Tradite, Kulture, Histori. Per organizimin e ketij aktiviteti, Bashkia Shkoder, ofroi mbeshtetjen e saj per aktivite te ndryshme te panairit si dhe mori pjese aktivisht me stenden e saj qe kishte qellim promovimin e qytetit te Shkodres si destinacion turistik. Panairi u zhvillua me date 10 Tetor, sipas nje formati te vecante me pjesemarrje e bizneseve te shumta qe operojne ne fushen e turizmit mori pjese aktivisht me mbeshtetje te aktiviteve dhe pjesemarrje ne kete panair.

Festivali i Filmit Mjedisor

Në kuadër të ditës botërore të biodiversitetit me datë 22 maj, Bashkimi Evropian në bashkëpunim me shumë partnerë si REC, GIZ, programi SELEA, Bashkia Shkodër dhe të tjerë mundësuan realizimin e Festivalit të Filmit Mjedisor në disa qytete të Shqipërisë ku ishte pjesë edhe qyteti i Shkodrës.

Falë bashkëpunimit me Bashkinë Shkodër, Festivali mjedisor u realizua në sheshin dhe në hollin e Bashkisë Shkodër me qëllim që pjesëmarrja publike të ishte sa më e lartë. Gjatë këtyre ditëve, aktivitetet filluan në sheshin e Bashkisë Shkodër me ekspozitën fotografike të biodiversitetit të përgatitur nga REC duke prezantuar rreth 24 specie të rralla të cilat kanë habitatin e tyre në Liqenin e Shkodrës. Kesaj ekspozite iu shtua edhe ekspozita mjedisore me punime të realizuara nga nxënësit dhe studentët e 12 shkollave nëntëvjeçare dhe të mesme të Qarkut Shkodër. Këto punime dhe fotografi terhoqën vëmendjen e shumë kalimtarëve dhe qytetarëve të Shkodrës, prindërve, mësuesve, fëmijëve, OJF-ve, përfaqësuesve të administratës publike të cilët ishin të shumtë gjatë kësaj ekspozite e cila zgjati për katër ditë rrallazi. Ajo shërbeu si një mesazh i fuqishëm nga ana e gjeneratës së re ndaj komunitetit që të mbronin mjedisin dhe, gjithashtu, biodiversitetin e larmishëm i cili po rrezikon të zhduket për shkak të faktorit “Njeri”. Aktivitetet vijuan, më pas, me shfaqjen e filmave mjedisore të cilët paraqitën realitetet mjedisore nga vende të ndryshme të botës dhe shërbyen si transmetues të fuqishëm të mesazhit “Ta mbrojmë mjedisin nëse duam që ai të na mbrojë”. Ishin të pranishëm në këto transmetime 4 ditore qytetarë të thjeshtë, ambjentalistë, shoqëria civile, studentë, përfaqësues të administratës publike etj. Shumë sukses pati edhe teatri me tematike mjedisore i realizuar në Shkodër për nxënës dhe studentë. Pjesëmarrja ishte e shumte dhe aktoret sollën në mënyra të ndryshme dhe prekën grupmoshat e ndryshme me mesazhe sensibilizuese mjedisore. Pavarësisht nga moti i papërshtatshëm, pjesëmarrja publike ka qënë e rëndësishme dhe të gjithë të pranishmit përshëndetën këtë iniciative (e re për qytetin e Shkodrës) dhe shprehën dëshirën që ky eveniment të bëhet i përvitshëm, të bëhet një zakon i këtij qyteti ashtu siç janë Festivali i Fëmijëve apo Festa e Luleve.

Aktiviteti Triathlon Labeat

Me datën 15 Shtator, 2013, me qëndër në Shirokë, u organizua për herë të parë aktiviteti “Triathlon Labeat” i cili përmbante në vetvete tregueshin sportiv Not, çiklizem dhe vrapim. Ideja dhe menaxhimi i aktivitetit ishte e shoqatës të “Sporteve Ujore Liqenore Shqiptare” në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Shkodër dhe Klubin Shumesportesh të Vllaznisë. Pjesëmarrësit i përkisnin dy grupmoshëve 7-15 vjeç dhe mbi moshën 16 vjeç që i përkisnin ekipeve sportive dhe amator të apasionuar jo vetëm nga qyteti i Shkodrës por dhe nga ekipet e Tiranës dhe Durrësit.

Organizimi i këtij aktiviteti u realizua në kuadër të programit promociional të Bashkisë Shkodër për promovimin e aseteve turistike të qytetit dhe veçanërisht Liqenit të Shkodrës.

RAPORT I AKTIVITETEVE TË MARRREDHËNIEVE ME JASHTË TË BASHKISË SHKODËR

Në përputhje me politikat strategjike të Bashkisë Shkodër për promovimin e historisë, kultures dhe turizmit të qytetit tonë, është ndjekur e njëjta linjë bashkëpunimi me bashkitë dhe komunat e vendeve mike, është ruajtur bashkëpunimi me organizatat e huaja dhe janë mbështetur projektet e tyre në të mirë të komunitetit.

Konkretisht, informojmë si më poshtë:

Partneritete dhe binjakëzime me qytete:

Bashkia Shkodër ka marrëdhënie partneriteti me Provincën Aquila (Itali), Kryeqytetin e Vjetër Mbreteror të Cetinjes (Mali Zi), Bashkinë Aplerbeck (Gjermani), Komunën Ferizaj (Kosovë), Komunën Ulqin (Mali Zi), Bashkinë Kecskemet (Hungari), Bashkinë Bar (Mali Zi), Komuna Torino (Itali), Bashkia Foggia (Itali), Komuna Ferrara (Itali), Yverdon Les Bains (Zvicër).

Marredhënie me shoqëri civile:

Në kuadër të bashkëpunimit të Bashkisë Shkodër me shoqatat vendase dhe të huaja që ushtrojnë aktivitet në qytetin tonë, janë organizuar me sukses disa panairë për produktet agrobujqësore dhe artizanale nga prodhues lokal si dhe është organizuar edicioni i dytë i Panairit të OJF-ve.

Ka filluar për herë të parë organizimi i tryezave të rrumbullaketa me përfaqësues të shoqërisë civile sipas profileve ku Bashkia është koordinatorë për prodhimin e strategjisë për europrojekte 2014-2020.

Forumet rajonale:

Bashkia Shkodër është anëtare e disa organizatave dhe konferencave ndërkombëtare dhe ndjek rregullisht punimet e aktivitetëve të tyre. Mund të përmenden të tilla si: EUROREGIONE, EURODISTRETTO. Agjensia për Demokracinë Lokale (LDA), CRANSMONTANA.

Në kuadër të bashkëpunimit të vendeve të Mesdheut, Bashkia Shkodër është anëtare dhe ndjek rregullisht veprimtaritë e Asamblese Lokale dhe Rajonale të Euro-Mesdheut (ARLEM).

Delegacione, vizita dhe takime.

Zyra e Maredhenjeve me Jashte, ne bashkepunim me kabinetin e Kryetarit te Bashkise, programon dhe ndjek vizitat e delegacioneve te huaja dhe trupit Diplomatik ne Shkoder.

Janar Komunikim per vendosjen e kontakteve me Shtepine e Terrorit ne Hungari si dhe miratimi i 3 projekteve me Ambasaden Hungareze.

Prill, Shkembim eksperience ne Yverdon les Bains (Zvicerr).

Maj Euronetlang project in Scutari, Albania / 6-9 May 2013.

Qershor, Takim me delegacionin e OSCE me z. Grossruck.

Korrik. Takim i kryetarit me organizaten Focus Europe ne Rome. Takim me Ambasaden Hungareze dhe percaktim i planit te bashkepunimit.

Shtator, Takim me kryetarin e komunes Ulqin, Takim me Konrad Adenauer Stiftung per bashkepunimin me muzeun e kujtetes historike Shkoder

Tetor, Takim me ambasadorin Italian per ndertesën e konsullates,

Takim me Ambasadorin Polak per bashkepunime te metejshme.

Nentor. Bashkepunim me Ambsadën e RSH ne BE dhe Komisionin European per organizimin e ekspozites Marubi ne Bruksel.

**DREJTORIA JURIDIKE DHE ASETIVE**

Ne mbeshtetje te buxhetit te vitit 2013 dhe ndryshimeve te bera gjate vitit sipas vendimeve te Keshillit te Bashkise Shkoder, nga Drejtoria e juridike, Prokurimeve dhe Aseteve jane kryer sherbime si me poshte si vijon:

I. Sektori Juridik

Gjate kesaj periudhe ka ushtruar detyren e saj ne disa procese dhe konkretisht ne proceset gjyqesore, marrja pjese aktive ne komisionet e shpronësimit te qirave dhe privatizimit te banesave shtetërore si dhe komisionet e vlerësimit. Ka hartuar urdhera te brendshem, urdheresa, projekt vendime, akt marreveshjeve dhe kontatave te sipermarrjes,

supervizimit dhe kolaudimit. Gjate vitit 2013 ka perfaqesuar ne 82 procese gjyqsore me objekte te ndryshme nga te cilat ; - 17 jane te pushuara, 28 jane gjykuar dhe 37 jane ne proces. Jane realizuar nga sherbimet e kryera nga zyra juridike (vertetime martesese), te ardhura nga qera ndertese, nga qera e trojeve, etj. Po shqyrton 2 raste duke bashkerenduar punen me komisionin ne zbatim te VKM 222 “Per tokat Bujqsore” Po shqyrton 10 raste duke bashkerenduar punen me komisionin ne zbatim te VKM 608 dt.: ”Per paisje me certifikate pronsie”. Po harton dokumentacionin e shpronsimit per 2 raste duke bashkerenduar punen me komisionin ne zbatim te VKM ”.

II. Sektori i Aseteve

Sektori i Aseteve gjate vitit 2013 ka ndjeke procesin e transferimit te pronave ne njesine e qeverisjes vendore, mbeshtetur ne dispozitat ligjore: Ligji Nr. 8652, date 31. 7. 2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Ligji Nr. 8744, date 22. 2. 2001 “Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore”. Vendimin Nr. 500, date 14. 8. 25001 “Per inventarizimin e pronave te paluajtshme shtetore dhe transferimin e pronave ne njesite e qeverisjes vendore” Udhezimin Nr. 15, date 30. 06. 2003 “Per Menyren e paraqitjes nga njesite e qeverisjes vendore te kerkesave per tranferimin ne pronesi te tyre te pronave te paluajtshme publike. VKM. Nr. 366, date 27. 03. 2008 “Per miratimin e listes paraprake te Pronave te paluajtshme publike, shtetore, qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim, te Bashkise Shkodër, te Qarkut Shkodër”. VKM Nr. 421, date 2. 06. 2010 “Miratim i listes se pjesshme te pronave shtetore qe kerkohen per transferim ne pronesi te Bashkise Shkodër. VKM Nr. 598, date 14. 5. 2008 “Per miratimin e listes përfundimtare te pronave, pyje dhe kullota, qe do te transferohen ne pronesi te njesisë se qeverisjes vendore, Bashkia Shkodër, te Qarkut te Shkodrës”. VKM Nr. 421, date 2. 06. 2010 është mbeshtetur ne VKB nr. 51, date 14. 04. 2009 “Miratim i listes se pjesshme te pronave shtetore qe kerkohen per transferim ne pronesi te Bashkise Shkodër ku pronat jane si me poshte:

Me VKM nr. 421, date 2. 06. 2010 „Per miratimin e listes përfundimtare (te pjesshme)te pronave te paluajtshme publike, shtetore, qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim te Bashkise Shkodër, te Qarkut te Shkodrës“ pronat qe kalohen ne pronesi te Bashkise Shkodër jane si me poshte:

Nr. rendor i pronës në listen e inventarit	Fusha e perdorimit të pronës	Nr. i pronave	Lloji i transferimit
7, 13-19, 21-23	Prona që përdoren në fushen Administrative	11	Ne pronesi
32-73, 851, 852, 853	Prona që përdoren për realizimin e programeve mesimore	50	Ne pronesi
78-86, 90-95, 854	Prona që përdoren në fushen e shendetit	16	Ne pronesi

	publik		
216;218÷225(pjesa e paprivatizuar);228÷234	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	16	Ne pronesi
241-248	Prona që përdoren në fushen e shërbimit social	8	Ne pronesi
107-109, 121-135, 173-205	Zhvillim ekonomik	51	Ne pronesi
330-403	Prona që përdoren në fushen e mbrojtjes civile	74	Ne pronesi
621-631	Prona që përdoren në fushen e ndriçimit publik	11	Ne pronesi
619-620	Infrastruktura vendore	2	Ne pronesi
578, 579	Sherbim funeral	2	Ne pronesi
Totali		241	

Janë dërguar për regjistrim ne ZVRPP Shkoder 150 prona. Nga keto janë rregjistruar 36 prona dhe mbetet pa rregjistruar 114 prona.

Faza e II^{te}

Jane derguar ne Ministrine e Mbrendshme ne A. I. T. P. P. VKB Nr. 144, datë 30. 12. 2009

“Lista e pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë

a) Miratimi i listes së pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të bashkisë Shkodër me fushe përdorimi “Lulishte” dhe “Rruge” me VKM Nr. 144, datë 30. 12. 2009.

❖ Prona që përdoren në fushen infrastrukturë shërbime publike, lulishta **46 prona**

❖ Prona që përdoren në fushen infrastrukturë shërbime publike, rruge **132 prona**

Gjithsej 419 prona

Jemi ne pritje te daljes se VKM per fillimin e rregjistrimit ne hipoteke të këtyre pronave për te cilat jemi në proces të hartimit të plan vendosjes se tyre.

Eshte bashkepunuar me Ministrine e Brendshme per mbarëvatjen e procesit te inventarizimit të aseteve të Bashkisë dhe janë zbatuar te gjitha Vendimet e Keshillit te Ministrave per pronat, gjithashtu eshte miratuar plani i menaxhimit pyje dhe kullota për një periudhë 10 vjeçare për pronat që janë në pronësi të Bashkisë Shkodër.

Janë përgatitur projektet

1. Aplikim i punimeve silvikulturale në pyjet artificial, vlera 436 320 lekë
2. Projekt pyllëzimi – Objekti Tarabosh (parcela nr. 28a, c), vlera 7 961 280 lekë

3. Ndertim lere uji në kullota, vlera 1 020 939 lekë

Totali 9 418 539 lekë, fond dhe projekte keto me te cilat do te aplikohet prane Ministrise Bujqesise dhe Donatoreve ne kuader te politikave te Permirsimit Pyjor.

Drejtoria Aseteve gjate kesaj periudhe ka ushtruar dhe detyren per Regjistrimin e aseteve në Zyren Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të transferuara ne pronesi të Bashkisë Shkodër pas miratimit ne Keshillin e Ministrave.

- Hapjen e dosjeve për çdo aset ku ne dosje janë vendosur planimetrite e ndertesës, plan rilevimin e ndertesës, çertifikaten e pronësisë (kur ka), vleresimet e gjendjes, etj.

Bashkerendimi i punes për vleresimin e aseteve private të propozuara per shpronësim per interes publik:

- Llogaritja e koston së përafert për shpronësim
- Hartimi i projekt vendimeve të këshillit bashkiak për shpronësimin e aseteve për nevoja publike në përputhje me ligjin Nr. 8561, datë 22. 12. 1999.
- Ka paraqitur pranë Këshillit të Ministrave propozimet e Këshillit Bashkiak për shpronësimet, duke iu përmbajtur kërkesave ligjore.
- Ka realizuar procedure zyrtare te shpronësimit me Këshillin e Ministrave transferimin e aseteve tek bashkia per përmbushjen e nevojave. Shpronësimi për vitin 2013 eshte kerkuar per dy rrugët ne investimet e poshteshenuara.

1. Rikonstruksion rruga Ajasem	4 743 195 lekë
2. Rikonstruksion Rruga Shkodër – Shirokë dhe Sheshi i Shirokës	1 379 400 leke
TOTALI	6 122 295 lekë

Gjithashtu jane realizuar:

- Shqyrtimi i kerkesave të qytetarëve në zbatim të VKM nr. 222, datë 6. 3. 2013 „Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve“.
- Shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve në zbatim të VKM nr. 608 „për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10. 8. 1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për rregjistrimin e tyre“.
- Eshte punuar për azhornimin e pronave sipas kerkesave, ne ndihmë të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.
- Pergatitja e dokumentacionit per nxjerrjen e koeficientit te bashkepronësise së truallit te objekteve të privatizuara sipas informacioneve që disponohet duke ju përmbajtur kërkesave të qytetarëve si informacionit që merret nga Ministria e Financave.
- Per pergatitjen e dokumentacionit hartografik për kontratat dhe akt marreveshjet që do të lidhen ndermjet bashkisë dhe të treteve do të pergatiten planimetria dhe gen- plani.

- Eshte bashkerenduar pune me drejtorine juridike, finances dhe urbanistikes ne lidhje me plotesimin e dokumentacionit te shpronsimit, per likujdim shpronsimesh dhe procese gjyqsore (vendime permbarimore).

III. Sektori i prokurimeve

Gjate vitit 2013 nga Drejtoria e Prokurimeve Publike, mbeshtetur ne miratimin e buxhetit dhe VKB perkatese, gjate vitit jane realizuar procedurat e prokurimit ne vleften prej 536 004 307 leke nga te cilat:

a) pune civile	56. 937. 131 leke
b) furnizime	41. 837. 940 leke
c) sherbime	429. 528. 799 leke
d) blerje te vogla	7. 700. 437 leke
TOTALI	536. 004. 307 LEKE



DREJTORIA ORGANIZIMIT, PERSONELIT, SHERBIMEVE MBESHTETESE, PROTOKOLL ARKIVIT DHE INFORMATIZIMIT

Drejtoria e Organizimit Personelit dhe Sherbimeve te Brendshme mbulon nevojat per shpenzimet operative per administraten e Bashkise dhe institucionet e varesise ku perfshihen: Teatri, Dega Ekonomike e Kultures, Klubi Shumesportesh “ Vllaznia”, Zyra e Arsimit (shkollat 9 vjeçare, te mesme, konviktet e sistemit parauniversitar, kopshte) si dhe Drejtorine e Çerdheve).

A. Ne vitin 2013 tek zeri shpenzime operative jane realizuar gjithsejt:

000/ leke

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Plani 2013	I pritshmi 2013
----	------------------------	------------	-----------------

602	Materiale dhe sherbime	53, 686, 000	47, 478, 373
6020	Materiale e sherb. zyre te pergjith.	6, 930, 000	5, 165, 183
6021	Materiale dhe sherbime speciale	480, 000	397, 500
6022	Sherbime	13, 574, 000	12, 457, 407
6023	Shpenzime transporti	6, 330, 000	5, 793, 583
6024	Shpenzime udhetimi	700, 000	34, 200
6025	Mirmbajtje e zakonshme	900, 000	263, 995
6026	Qera objekteve	450, 000	379, 500
6027	Detyrime dhe kompensime legale	11, 000, 000	11, 000, 000
6029	Shpenzime te tjera operative	13, 322, 000	11, 987, 005

Me poshte eshte analiza e shpenzimeve sipas grupeve dhe ne menyre analitike:

- ❖ **Materiale e sherbime zyre te pergjithshme** “ realizimi per vitin 2013 eshte ne vleren **5 165 183 leke** i detajuar si me poshte:
 - Zeri ”**Kancelari**” eshte realizuar me tender ne vleren prej **2 812 417 leke**.
 - Zeri “**Materiale per pastrim, dizinfektim, ngrohje dhe ndricim**” i parashikuar per blerje materiale pastrimi, shpenzime te cilat ishin planifikuar sipas kerkesave te institucioneve te varesise eshte realizuar me tender ne vleren **1 505 386 leke**, ndersa **198 210 leke** per shpenzime materiale elektrike dhe artikuj industriale, pra realizimi per kete ze eshte ne vleren prej **1 703 596 leke**.
 - Tek ” **Materiale per funksionimin e paisjeve speciale**” i parashikuar per blerje materiale per funksionimin e paisjeve te ndryshme kompjuterike si tastiera, mausa, karta Ram, motherboard, karta grafike, karta rrjeti, bateri etj eshte realizuar ne vleren prej **220 mije leke**.
 - Tek zeri “**Blerje dokumentacioni** “ eshte realizuar ne vleren prej **314 270 leke** per blerje shtypshkrime per nevoja te institucioneve te varesise dhe administrates se bashkise.
 - Zeri “**Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjithshme**” eshte realizuar ne vleren prej **114 900 mije leke** per shpenzime per funksionimin e fikseve te zjarrit, blerje vula etj.
 - Zeri “**Sherbime speciale**” i parashikuar per blerje te uniformave te policise bashkiake, bazuar ne vendimin e keshillit te ministrave nr. 333 date 02. 06. 1998 per “Miratimin e normes se veshmbathjes per policine” per kostume, pantallona verore, xhakovento, kemisha, kepuce, pulovra, stema doreza pune etj eshte realizuar ne shumen prej **397 500 leke**.
- ❖ Zeri “**Sherbime**” realizimi eshte ne vleren **12 457 407 leke** i detajuar si me poshte:
 - Zeri “**Energji elektrike** “ realizimi per vitin 2013 eshte ne vleren prej **3 000 mije leke**.
 - Zeri “**Uje**” i parashikuar per shpenzime uji, eshte ne vleren prej **600 mije leke**.

- Zeri “**Telefon**” i parashikuar per shpenzimet per telefonine celulare per titullaret ne baze te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 864, dt 23. 07. 2010 si dhe telefonine fikse per titullaret dhe drejtorite realizimi per viti 2013 eshte ne vleren prej 422, 480 mije leke.
 - Zeri “**Postare**” i parashikuar per shpenzime sherbime telegrafike e postare, realizimi eshte ne vleren prej 200 mije leke.
 - Zeri “**Lende djegese**”i parashikuar per shpenzimet per gaz per ngrohje dhe gatim sipas kerkesave te paraqitura nga drejtorite dhe institucionet e varesise eshte realizuar ne vleren prej 7 497 091 leke.
 - Zeri “**Roje**” realizimi eshte ne vleren prej 72 000 leke.
 - Zeri “**Sherbime te printimit dhe publikimit** ” realizimi per vitin 2013 eshte ne vleren prej 76 mije leke per njoftimet ne media.
 - Zeri “**Sherbime te tjera**” i parashikuar per shpenzimet per sherbim interneti, sherbim faqen e internetit te Bashkise, pagese sherbim AKEP, sherbim larje tapeta, realizimi eshte ne vleren prej 589 836 leke.
- ❖ Zeri “**Shpenzime transporti** “realizimi eshte ne vleren prej 5 793 583 leke si me poshte:
- Zeri “**Shpenzime karburant**” i parashikuar per shpenzimet per blerje karburant per kaldaja dhe automjete, keto sipas nevojave te institucioneve te varesise dhe administrates eshte realizuar ne vleren prej 4 966 027 leke.
 - Zeri “**Pjese kembimi** “i parashikuar per shpenzimet per pjese kembimi goma, bateri etj. eshte realizuar ne vleren prej 399 mije leke per riparimet e automjeteve te administrates, policise bashkiake, inspektoriatit ndertimor, drejtorise se te ardhurave, motor gjeneratorit, autoshkalles dhe elektrovinçit.
 - Zeri “**Siguracion** “ i parashikuar per siguracionet e makinave te administrates, policise bashkiake inspektoriatit ndertimor dhe drejtorise se te ardhurave eshte realizuar ne vleren prej 134 467 leke.
 - Zeri “**Shpenzime te tjera**” i parashikuar per riparimet e avarive te makinave te administrates, motor gjeneratorit, autoshkalles, elektrovinçit, makines se vizimit, prerases etj eshte realizuar ne vleren prej 294 089 mije leke.
- ❖ Zeri “**Shpenzime udhetimi**” realizimi per vitin 2013 eshte ne vleren prej 34 200 leke.
- ❖ Zeri “**Mirembajtje e zakonshme**” realizimi eshte ne vleren prej 263 995 leke i detajuar si me poshte:
- Zeri” **Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore**”eshte realizuar eshte ne vleren prej 143 995 leke.
 - Zeri “**Mirembajtje per aparate paisje teknike**” i parashikuar per mirembajtje aparate teknike, mirembajtje paisje fonie, riparime skanera/pc/fotokopje, printera etj realizimi eshte ne vleren prej 120 mije leke.

- ❖ Zeri “*Qera objekte*” realizimi eshte ne vleren prej **379 500 leke**.
- ❖ Zeri “*Detyrime dhe kompensime legale*” i parashikuar nga Drejtoria Juridike per v. 2013, realizim + i pritshem eshte ne vleren prej **11 000 mije leke**.
- ❖ Zeri “*Shpenzime te tjera operative*” eshte realizuar ne vleren prej **11 987 005 leke** si me poshte:
 - Zeri “*Shpenzime pritje percjellje*” qe ishte parashikuar per pritje percjellje te delegacioneve te huaja dhe kombetare realizimi eshte ne vleren **450 mije leke**.
 - Zeri “*Aktivitete te ndryshme*” eshte realizuar ne vleren prej **794 808 leke** per dreken e Iftarit, festen e liqenit dhe aktivitetin e 2 Prillit.
 - Zeri “*Siguracioni i nderteses*” eshte realizuar ne vleren prej **469 999 leke**.
 - Fondi i planifikuar ne zerin “*Honorare dhe shpenzime kompensimi*” realizimi i vitit 2013 eshte ne vleren prej **9 084 600 leke** per honorare K. Bashkiak dhe kujdestarë.
 - Zeri “*Te tjera materiale e sherbime operative*” realizimi i v. 2013 eshte **1 187 598 leke**.
- B.** Zeri “*Investime*” per vitin 2013 eshte realizuar ne vleren **1 122 108 leke** te ndara: Blerje ndertesa dhe konstruksione realizimi eshte ne vleren prej **427 188 leke**, ndersa per blerje pajisje zyre realizimi eshte ne vleren prej **694 920 leke**.

BURIMET E FINANCIMIT


TE ARDHURAT

Te ardhurat e njesive te qeverisjes vendore perbehen nga:

I.1 TE ARDHURAT

I.2 TE ARDHURAT NGA BURIME KOMBETARE

	000/leke	ne %
Burimet e Financimit	Plani 2014	Peshe specifke
	411,0	
Transferta e pakushtezuar	27	52.4%
	373	
Ardhurat e veta & Donator	,400	47.6%
	784	
Shuma	,427	



TE ARDHURAT

Te ardhurat e Bashkise Shkoder perbehen nga:

1.1 TE ARDHURAT E VETA

Ndarja e te ardhurave sipas kategorive:

3. Te ardhura nga taksa vendore:

Taksat ndahen si me poshte:

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel

Në ligjin Nr. 181/2013 date 28. 12. 2013 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin 9632. . . ”

Neni 1 dhe 2 ndryshon ligjin 9632 dt. 30. 10. 2006 “Per sistemin e Taksave Vendore” ku është shfuqizuar taksa e biznesit të vogël dhe zëvendësuar nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël me norme tatimore 7. 5%, Për subjektet, me qarkullim nga 0 deri në 2 milionë lekë në vit, është miratuar një taksë fikse prej 25 000 lekë në vit.

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin mblidhet nga Drejtoria Rajonale Tatimore ne rolin e agjentit nga cdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë. Procedurat percaktohen ne ligjin nr. 9632, datë 30. 10. 2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

Per kete sherbim Drejtoria Rajonale Tatimore mban nje komision prej 1% te vleres se grumbullar.

Taksa mbi pasurine e paluajtshme

Taksas mbi pasurine e paluajtshme i nenshtrohen te gjithe personat fizike ose juridike, biznese dhe familjare, pronare te pasurive ndertesat. Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nivelet treguese te taksas orientohen sipas aneksit 1 te ligjit nr. 181/2013 date 28. 12. 2013 “Per disa ndryshime ne Ligjin 9632 „Per sistemin e taksave vendore“ me te drejten per ndryshim +/- 30% nga organi legjislativ i bashkise.

Në nenin 3 te ligjit nr. 181/2013 date 28. 12. 2013 miratohet detyrimi i zyrave vendore të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme që t’u ofrojnë njësive të qeverisjes vendore regjistrimin e të dhënave të pasurisë, një instrument ky i munguar për njësitë vendore për miradministrimin e mbledhjes së taksave të pasurisë.

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katrorë e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të tatimpaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi. Kategoritë minimale të ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepen në aneksin 1 që i bashkëlidhet ligjit të taksave vendore. Për çdo kategori minimale të ndërtesave, këshilli bashkiak ose komunal mund të miratojë nënkategorizime të ndërtesave që ndodhen brenda territorit që mbulon.

Gjithashtu, me Vendim te Keshillit te Ministrave eshte miratuar rritje dyfish e taksës së ndërtesës që përdoret për qëllime biznesi dhe qëllime te tjera dhe konkretisht në fund të pikës 1, të nenit 22, “Taksa mbi ndërtesat”, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje: “Personat fizikë, të cilët kanë më shumë se një shtëpi, për shtëpinë ku kanë banimin e zakonshëm, paguajnë taksën e ndërtesës sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij ligji, ndërsa për të gjitha shtëpitë e tjera, taksa e ndërtesës është sa dyfishi i taksës së ndërtesës, që zbatohet në zonën ku ndodhet kjo ndërtesë.

Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja

Baza e takses eshte vlera ne Leke e investimit te ri qe kerkohet te kryhet, ndersa niveli shprehet si perqindje e vleres se investimit dhe shlyhet nga investitori. E ardhura nga kjo takse mblidhet nga organi qe leshon lejen e ndertimit.

Taksa vjetore e mjeteve te perdorura te transportit rrugor

Detyrimi per kete takse llogaritet sipas pikes 3, te nenit 4 te Ligjit Nr. 9975, dt. 28. 07. 2008 “per Taksat Kombetare” i ndryshuar. Detyrimi per taksen i takon pronarit te mjetit sipas vendbanimit ose selise se tij. E ardhura nga taksa mblidhet nga strukturat e Drejtorise Rajonale te Sherbimeve te Transportit Rrugor.

Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme

Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme vendoset ne çastin e kalimit te se drejtes se pronesise bazuar ne siperfaqen e ndertimit te prones qe transferohet nga personi qe kalon te drejten e pronesise, dhe llogaritet nga zyrat e regjistrimit te pasurive te paluajtshme ne rolin e agjentit tatimor.

Taksa e fjetjes ne hotel

Baza e takses eshte çmimi i fjetjes, sipas rastit, per dhome ose per person, per nje nate. Niveli i takses eshte 5% e çmimit te fjetjes. Detyrimi per taksen i takon klientit qe strehohet ne hotel dhe mbahet nga hoteli per llogari te bashkise.

Neni 6, i ligjit nr. 181/2013, lidhet me përmirësimin e procedurës së administrimit nga pushteti vendor të taksës së fjetjes në hotel. Konkretisht, miratohet që çdo gjashtë muaj hotelet të paraqesin për miratim çmimet e fjetjes në hotel tek bashkitë dhe komunat, te cilat miratojnë çmimet çdo gjashtë mujor, për efekt të taksës së fjetjes në hotel, bazuar në sondazhet e kryera në treg.

Taksa te tjera:

Taksa per zenien e hapesires publike per qellime biznesi llogaritet si detyrim mujor dhe shprehet ne meter katror siperfaqe publike te zene.

Taksa e tabelës ndahet sipas qellimit te tabelës ne:

- tabela per bizneset per qellime identifikimi, te trupezuar ne siperfaqen e nderteses ose brenda territorit ku zhvillon aktivitetin, dhe kur nuk perdoret per te reklamuar aktivitetin e te treteve.

- tabela per qellime reklamimi, te thjeshta dhe elektronike.

4. Te ardhura jo tatimore

Te ardhura nga tarifat vendore, siç jane tarifat e pastrimit, ndriçimit, gjelberimit vilen ne baze te ligjit 8652, dt. 31. 07. 2000 „Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore“, dhe paguhen nga bizneset, institucionet e familjaret. Bashkia krijon te ardhura nga tarifat vendore per sherbimet publike qe ofron, si pastrim, gjelberim, ndriçim, duke u orientuar ne pergjithesi ne perafrimin e kostos se tyre.

Me shfuqizimin e taksës së biznesit të vogël, është bere edhe heqja e kufizimit për tarifat per bashkitë dhe komunat, i cili ka ndikuar në politikëbërjen e njësive, të cilat tashme kanë diskrecionin e duhur për vendosjen e masës së tarifave dhe taksave të tyre të përkohshme.

Te ardhura te tjera jotatimore, siç jane te ardhura nga veprimtarite ekonomike, te ardhura nga shitja e pasurive kapitale te njesise vendore te lejuara me ligj, te ardhura nga qerate mbi trojet, ndertesat dhe objektet e tjera vendore, te ardhura nga kontribute dhe sponsorizime te ndryshme, si ndihma, dhurime, sponsorizime, te ardhurat nga gjobat dhe kundravajtjet administrative“, si dhe nga te ardhura te tjera.

Te ardhura nga institucione varesie te njësive te qeverisjes vendore, ku bejne pjese pagesat per çerdhet, pagesat per kopshtet, pagesat e nxenesve te shkollave te mesme, pagesat nga konviktor me burse, gjysme-burse, si dhe te ardhura te tjera nga institucione vendore.

Te ardhurat e parashikuara nga biznesi, duke perfshire edhe taksen e ndikimit ne infrastrukture, zene 50% te te ardhurave te veta, ndersa se bashku me taksat dhe tarifat familjare, duke perfshire edhe parkingun per mjetet personale, zene rreth 75% te te ardhurave te Bashkise Shkoder.

Te dhenat per taksapaguesit familjare perpunohen dhe administrohen nepermjet sistemit te kompjuterizuar te ndermarrjes se Ujsjelles Kanalizime, qe ne rolin e agjentit tatimor bashke me tarifat per sherbimin e ujit vjel edhe taksat dhe tarifat familjare. Taksat dhe tarifat vilen ne baze mujore, dhe mund te paguhen ne cdo arke te ndermarrjes se Ujesjelles Kanalizime te shperndare ne qytetin e Shkodres si dhe nepermjet te gjitha bankave te nivelit te dyte.

Strategjia e rritjes se te ardhurave si nga biznesi ashtu dhe nga familjaret shihet ne shtrirjen e bazes se taksapaguesve dhe ne saktesimin e te dhenave te taksueshme te subjekteve, gje qe

realizohet nga Drejtoria e te Ardhurave edhe nepermjet bashkrendimit te punes me drejtorite paralele dhe institucionet e pushtetit qendror si Drejtoria Rajonale Tatim-Taksave, Zyra Regjistrimit Pasurive Paluajtshme, QKR etj, .

Arketimet per taksa dhe tarifat familjare planifikohet te ruajne tendencen ne rritje, kjo kryesisht nepermjet sensibilizimit te taksapaguesve familjare, kontaktet nga afer me institucionet shtetore per shlyerjen nga punonjësit buxhetore te ketij detyrimi dhe ne ndjekjen e masave shtrenguese ligjore.

Te ardhurat e veta luajne nje rol te madh per sigurimin e burimeve financiare ne funksion te realizimit te misioneve te shumta te Bashkise ndaj qytetareve te saj, bazuar ne ligjin Nr. 8652 „Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore“.

Me ndryshimet ne kuadrin ligjor fiskal, ne baze te ligjit Nr. 9632 „Per sistemin e taksave vendore“, zyrat tatimore vendore administrojne taksat, detyrimet tatimore dhe pagesat publike vendore, pervec tatimit te thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel.

Biznesi i vogel nuk paguan me taksen e biznesit te vogel por tatim te thjeshtuar mbi fitimin dhe kjo pagese behet ne Drejtorine Rajonale Tatimore. Biznesi i madh, i vogel, Sh.A.O.J.F, Institucionet etj. do te vazhdojne te likuidojne tarifat e pastrimit, ndriçimit, gjelberimit, taksen e ndertes, taksen e tabelës dhe taksa te tjera per hapësirat publike prane bashkise Shkoder.


Sipas kuadrit ligjor ne fuqi bashkia vazhdon te administroje dhe vjele taksen e ndertes, tarifat e pastrimit, gjelberimit, ndriçimit, taksen e tabelës, tarifat per zenien e hapësirave publike per qellime reklamimi, parkimi, hapësirash publike etj.


Gjithashtu bashkia Shkoder vazhdon te administroje dhe te ndjeke masat shtrenguese ne baze te ligjit Nr. 9920 „Per procedurat tatimore“ te gjithe subjektet debitore dhe te palicensuar ne gjithe shtrirjen territoriale brenda juridiksionin te saj.

Planifikimi per vitin 2014 eshte bere duke ruajtur tendencen ne rritje te numrit te bizneseve, si dhe duke ndjekur dinamiken e ndryshimeve ne legjislacion.

Burimet kryesore jane planifikuar ne rritjen e baze taksapaguese, rritjen e konkurrencës se ndershme, goditjen e evazionit fiskal, uljen e numrit të subjekteve debitore, implementimin dhe zbatimin e ligjit dhe ndërtimin e marrëdhënies te mira me taksapaguesit, rritja e sensibilitetit te biznesit per perfshirjen ne skemen e tatimpaguesve te rregullt, rritja e

ndergjegjesimit ne njohjen dhe zbatimin e ligjit, përqendrimi i administrates se bashkise ne detyrat e veta, si dhe bashkepunimi i mire ndersektorial dhe institucional brenda drejtorive te bashkise si dhe jashte saj me institucione te tjera te perfshira.





1.2 TË ARDHURA NGA BURIME KOMBETARE

Njësitë e qeverisjes vendore financohen nga këto burime kombëtare:

1. Transferta e Pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit.

Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit është e ardhur për njësitë e qeverisjes vendore, e përfituar në formën e dhurimit pa kusht kthimi, pa interes, e cila përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet e veta dhe të përbashkëta të njësive të qeverisjes vendore, të përcaktuara në ligjin Nr. 8652, datë 31. 07. 2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, si dhe për arritjen e barazisë së burimeve mes njësive të ndryshme të qeverisjes vendore në raport me mundësitë e tyre për të krijuar të ardhurat e nevojshme.

Me transferimin e taksave në njësitë e qeverisjes vendore, në formulë u vendos edhe elementi ekualizues për rregullimin e transfertës për njësitë e qeverisjes vendore në përshtatje me kapacitetet fiskale të tyre.

Formula e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2014 bazohet në:

- a. *Të dhënat e popullsisë për vitin 2014, janë marrë nga “Regjistri themeltar i shtetasve” nga Gjendja Civile, e konkretisht të dhënat për muajin Shtator 2013.*
- b. *Në transfertën e pakushtëzuar janë përfshirë:*
 - *Fonde për administrimin e konvikteve të arsimit parauniversitar.*
 - *Fonde për administrimin e katër qendrave të shërbimit të kujdesit social.*
- c. *Të ardhurat nga biznesi i vogël dhe taksa e automjeteve të përdorura për efekt të kapacitetit fiskal janë llogaritur nga të dhënat faktike të vitit 2012.*
- d. *Niveli minimal për frymë, për vitin 2014 do të jetë:*
 - *për bashkitë, 3, 220 lekë/frymë,*
 - *për komunat 2, 000 lekë/frymë.*

Në ligj thuhet se përcaktimi i madhësisë së transfertës, qeveria është bazuar në: funksionet transferuar te njësitë e qeverisjes vendore, fondet respektive për to, si dhe rregullimet specifike mbi bazë vjetore, bazuar në transferimin e taksave.

Gjithashtu në ligj thuhet: “Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet me formulë në vetvete përbën një tregues cilësor për decentralizimin dhe për vitin 2014, ajo është 8 për qind më e lartë se në vitin 2013”.

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2014 për Bashkinë Shkodër është **411 027 mijë leke**.

Transferta e pakushtëzuar në vitin 2013 Bashkinë Shkodër ishte **409 901 mijë leke**.

Rritja është vetëm 0. 27% në krahasim me 2013 gje që bie në kundërshtim me ligjin e buxhetit të vitit 2014 ku thuhet se transferta do të jetë 8% më e lartë se në vitin 2013.

2. Transferta të Kushtëzuara nga Buxheti i Shtetit

Transferta e kushtëzuara në buxhetin e vitit 2014, jepet për financimin e shpenzimeve për funksionet e përbashkëta dhe për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Këto fonde do të përdoren nga njësitë e qeverisjes vendore vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë dhe në përputhje me rregullat e caktuara nga pushteti qendror. Njësitë e qeverisjes vendore nuk mund ti përdorin për qëllime të tjera, përveç atyre të përcaktuara.

Per buxhetin e vitit 2014 transferta e kushtezuar qe do akordohet per Bashkine Shkoder do konfirmohet nga Ministrite e linjes gjate vitit 2014.

Në fondet e kushtëzuara për funksionet e përbashkëta përfshihen:

- **Transfertat e Kushtëzuara për funksionet e përbashkëta.**
- **Fondet për zhvillimin e rajoneve.** Ne baze te Aneksit nr. 3 te ligjit “Për buxhetin e vitit 2014”, per shpërndarjen e fondeve te rajoneve ngrihet komiteti vlereresimit dhe miratimit te projekteve.

Aplikimi për fonde bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, duke i dërguar projektet në:

- Fondin Shqiptar të Zhvillimit për objektet e infrastrukturës vendore.
- Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për objektet arsimore.
- Ministrinë e Shëndetësisë për objektet shëndetësore.
- Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për objektet e ujësjellës kanalizimeve.
- Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për objektet ndërtim tregjesh agro-ushqimorë, thertoresh dhe objekte për ujitje/kullim.
- Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për objektet kulturore.
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbehet nga:

- *Granti konkurrues për infrastrukturën vendore*
- *Granti konkurrues për arsimin baze parauniversitar dhe universitar*
- *Granti konkurrues për shendetesine*
- *Granti konkurrues për objektet kulturore*
- *Granti konkurrues për ujësjellës kanalizime*
- *Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh*
- *Granti konkurrues për Ujitjen dhe Kullimin*

- *Granti konkurrues për Pyllëzimet*

- **Arsimi parauniversitar**

Investimi: Ne buxhetin e Ministrisë se Arsimit dhe te Shkencës për vitin 2014, janë te planifikuar fondet për investime për arsimin parauniversitar ne Fondin per Zhvillimin e Rajoneve. Njësite e qeverisjes vendore do te përfitojnë këto fonde nëpërmjet paraqitjes se projekteve pranë Ministrisë se Arsimit dhe te Shkencës dhe te vlerësimit te tyre nga Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve krijuar për këtë qellim, nëpërmjet konkurrimit, Njësite e qeverisjes vendore mund te financojnë edhe nga te ardhurat e veta ne arsimin.

- **Transfertat e Kushtëzuara për Funkcionet e Deleguara**

- Fonde për Ndhmën Ekonomike për Pagesën e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe për Përkujdesjen Shoqërore.
- Fondet e kushtëzuara për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe përkujdesjen shoqërore, janë fonde të Ministrisë se Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta pra përfshihen në buxhetin e kësaj Ministrie. Ato ju delegohen njësite të qeverisjes vendore të cilat bëjnë vlerësimin e nevojave si dhe kryejnë pagesat e ndihmën ekonomike, të personave me aftësi të kufizuar dhe për përkujdesjen shoqërore. Per buxhetin e vitit 2014 transfertat e kushtezuar qe do akordohet per Bashkine Shkoder do konfirmohet nga Ministrite e linjes gjate vitit 2014.

KAPITULLI SHPENZIMEVE

Shpenzimet e njësive të qeverisjes vendore ndahen në:

II. 1 SHPENZIME PËR FUNKSIONET E VETA (EKSKLUZIVE)**II. 2 SHPENZIMET PËR FUNKSIONET E PËRBASHKËTA****II. 3 SHPENZIME PËR FUNKSIONET E DELEGUARA**

Funksionet e veta, përfaqësojnë funksionet që janë përgjegjësi ekskluzive e vetë njësive të qeverisjes vendore.

Financimi i tyre bëhet nga të ardhurat e veta të njësive të qeverisjes vendore dhe nga transfertat e pakushtëzuara të buxhetit të shtetit.

Në shpenzimet për funksionet e veta përfshihen:

- *Të gjitha shpenzimet për administratën vendore duke përfshirë pagat, kontributin e sigurimeve shoqërore, shpenzimet operative dhe **investime**.*
- *Të gjitha shpenzimet për shërbimet publike si: pastrim, gjelbërim, dekor, funeral, ndriçim qyteti etj. duke përfshirë kosto të personelit, shpenzime operative dhe **investime**.*
- *Të gjitha shpenzimet për institucionet vendore të kulturës dhe sportit (me përjashtim të shpenzimeve për cilësinë sportive, ku Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinise dhe Sporteve mbulon me grantin e saj, financimin e sportistëve dhe trajnerëve cilësore.*
- *Të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrugëve vendore duke përfshirë kosto të personelit, shpenzime operative dhe **investime**.*
- *Shpenzimet për transportin urban.*

II. 2 SHPENZIMET PER FUNKSIONET E PERBASHKETA

Funksionet e përbashkëta, lidhen me ato fusha të veprimtarisë që janë përgjegjësi e përbashkët e qeverisjes qendrore dhe njësive të qeverisjes vendore, përgjegjësi kjo e ndare qartë për secilin nivel.

Shpenzimet për kryerjen e funksionëve të përbashkëta përballohen nga:

- Transferta e pakushtëzuar e buxhetit të shtetit për njësitë e qeverisjes vendore.
- Të ardhurat e veta të njësive të qeverisjes vendore.
- Grantet konkurruese (fondet e zhvillimit rajonal) për investime në arsimin parauniversitar.

- Grantet konkurruese (fondet e zhvillimit rajonal) për investime në kujdesin parësor shëndetësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

➤ **Arsimin:**

Mirëmbajtjen dhe funksionimin e shkollave të cilat financohen nga burimet e veta vendore. Këto shpenzime miratohen në buxhetin e pavarur të njësive vendore.

Investime në arsimin parauniversitar, të përfituara nga njësitë e qeverisjes vendore nga granti konkurrues për arsimin. Këto shpenzime miratohen në buxhetin e kushtëzuar të njësive vendore.

Njësitë e qeverisjes vendore mund të financojnë nga të ardhurat e veta për ndërtim, rikonstrukcion dhe pajisje të kopshteve dhe shkollave të arsimit parauniversitar dhe në këtë rast shpenzimet miratohen në buxhetin e pavarur të njësive vendore.

Shpenzimet për trajtimin ushqimor të nxënësve bursistë, konviktore përballohen nga fondet buxhetore, të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

II. 3 SHPENZIME VENDORE PER FUNKSIONET E DELEGUARA.

Në shpenzimet vendore për funksionet e deleguara përfshihen:

Shpenzimet për mbrojtjen sociale

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta detajon në fillim të vitit 2013, fondet e ndihmës ekonomike dhe pagesën e paaftësisë. Këto fonde i delegohen çdo njësie të qeverisjes vendore që në fillim të vitit.

Shpenzimet për përkujdesjen shoqërore

Financimi i shërbimeve të përkujdeset shoqëror, që realizohen nga bashkitë komunitat dhe qarqet, do të bëhen nga buxheti i shtetit, si dhe të ardhurat vendore. Fondet nga buxheti jepen në formën e grantit të kushtëzuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta që në fillim të vitit,

- Bashkitë dhe komunitat administrojnë shërbimet e përkujdesjen shoqërore për qendra të përkujdeset që u shërbejnë individëve, banorë të bashkisë ose komunës si dhe shërbimet e përkujdeset për këta individë.

Shpenzimet për këtë qëllim që përballohen me fonde të kushtëzuara nga buxheti i shtetit përfshihen në buxhetin e kushtëzuar të njësive të qeverisjes vendore.

III. SHPENZIMET QË KRYHEN NGA NJESITË E QEVERISJES VENDORE PER LLOGARI TË PUSHTETIT QËNDROR, POR QË NUK JANË SHPENZIME VENDORE DHE NUK MIRATOHEN NË BUXHETIN VENDOR NGA KESHILLI PERKATËS.

- **Shpenzimet për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore për QKR.**
- Shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për kryerjen e shërbimit të gjëndjes civile.**

DISA ELEMENTË TË SHPENZIMEVE BUXHETORE

- **Paga dhe shtesat mbi paga (Artikulli 600)**

Këtu përfshihen shpenzimet për pagën baze dhe shtesat mbi page. Numri i punonjësve për administratën e njësisë së qeverisjes vendore dhe për personelin e ndërmarrjeve në varësi të njësisë së qeverisjes vendore përcaktohet nga këshilli përkatës i njësisë. Paga bazë sipas klasave dhe shtesat mbi pagë do të përllogariten në bazë të V. K. M Nr. 586 date 17. 7. 2013 Per disa ndryshime ne vendimin 1619 date 2. 7. 2008 te Keshillit te Ministrave “Për klasifikimin e funksionëve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organëve të qeverisjes vendore”.

Përllogaritja e Fondit te Veçante dhe përdorimi i tij, behet sipas Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 929 Date 17. 11. 2010 « Mbi krijimin dhe perdorimin e fondit te vecante nga njesite e qeverisjes se pergjithshme” ndryshuar me VKM 493 date 63. 7. 2011, VKM nr. 826 date 5. 12. 2011, VKM 949 date 6. 12. 2012. Për kompensimet, do të zbatohet V. K. M Nr. 499, datë 13. 08. 1998, ndryshuar me V. K. M Nr. 683, datë 28. 10. 1998.

Sipas VKM Nr. 1619, datë 2. 7. 2008, këshillat e njësive të qeverisjes vendore miratojnë shpërblimin mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave në masën deri në 10 për qind të pagës, përkatësisht, të kryetarit të këshillit të qarkut, kryetarit të bashkisë, kryetarit të njësive bashkiake dhe atij të komunës.

Bazuar ne ligjin nr. 185/2013 date 2. 12. 2013 ” Per buxhetin e vitit 2014” neni 15: ” Bashkitë, që kanë mbi 50 001 banorë, përdorin deri në 15 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ “.

• Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (Artikulli 601)

Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të ligjit 10070 date 5. 2. 2009 “Për disa ndryshime të ligjit Nr. 7703, datë 11. 05. 1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar dhe të ligjit Nr. 7870, datë 13. 10. 1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, do të jetë nga punëdhënësi përkatësisht 16. 7 % dhe nga punëmarrësi 11. 2 %.

Ne baze të VKM nr. 581 date 17. 7. 2013 që ka ndryshuar VKM 1114 date 30. 7. 2008 fondi i pagave mbi të cilin llogaritet kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet sipas: Paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore është 21 000 leke, ndërsa paga maksimale 105 000 leke.

Ndërsa në baze të vkm 573 date 3. 07. 2013 paga minimale është 22 000 leke.

a. Planifikimi për mallra dhe shërbime të tjera (Artikulli 602)

Planifikimi i shpenzimeve për “Mallra dhe shërbime të tjera” (shpenzime operative) për vitin 2013, do bëhet sipas ndarjes në nënartikuj sipas klasifikimit ekonomik për çdo funksion në veçanti. Për secilin nga zërat e përfshirë në këtë artikull planifikimi i nevojave duhet të mbështetet në normativa sa më të drejta të vendosura nga bashkitë dhe komunat. Në baze të ligjit 10160 date 15. 1. 2009 i ndryshuar me ligjin 169/2013 “ Per rregullimin e shërbimit të transportit për funksionaret publike dhe nepunesit civil” tabela 2 përfitimi financiar (bonus) mujor për shërbimin e transportit për Kryetarin e Bashkisë është 45 mijë leke në muaj.

b. Planifikimi për investime (231)

Investimet përballohen nga të ardhurat e veta të njësisë të qeverisjes vendore, transfertat e pakushtëzuar, si dhe nga buxheti i shtetit. Të gjitha fondet për investime do të menaxhohen sipas procedurave të përcaktuara në:

- Ligjin Nr. 9643, datë 20. 11. 2006, “Për prokurimin publik”
- Ligjin Nr. 8652, datë 31. 07. 2000, ”Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”
- V. K. M Nr. 1, datë 10. 01. 2007, “Rregullat e prokurimit publik” etj.

3. Fondet e investimeve (230, 231) nga grandet prej fondeve të zhvillimit rajonal.

Procedurat e prokurimit të këtyre fondeve kryhen mbi bazën ligjore të cilësuar më lart. Këto procedura fillojnë pas marrjes së shkresës nga Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

për akordim fondi sipas destinacionit të përcaktuar. Të gjitha fondet për investime nga granti konkurrues të cilat akordohen nga Ministria e Brendshme prokurohen drejtpërdrejt nga njësia vendore pavarësisht nga vlera.

4. Fonde të tjera për investime

Për fonde të tjera për investime (me burim financimi të ndryshëm) që miratohen nga Ministria e Brendshme do të zbatohet V. K. M Nr. 1, datë 10. 01. 2007.

5. Investimet që kryhen në njësitë e qeverisjes vendore

Fondet për investime që kryhen në njësitë e qeverisjes vendore kanë si burim financimi të ardhurat e tyre dhe transfertën e pakushtëzuar.

➤ Për Fondin e Kontigjences

Bazuar në Nenin nr. 19/7. a. iii të ligjit nr. 8652 datë 31. 07. 2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe nenit 6 te ligjit nr. 9936, date 26. 06. 2008, Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, krijohet Fondi Rezervë. Per të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontigjences. Te dy këto fonde miratohen në masën deri ne 3 (tre) për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

Per vitin 2014 eshte parashikuar nje Fond Rezerve keto fonde jane parashikuar **10 000mije leke**.


➤ Per Detyrimin e Keshillit te Qarkut

Ne baze te ligjit nr. 8652 date 31. 07. 2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”Neni 18 njësitet e qeverisjes vendore derdhin një kuote për llogari te Këshillit te Qarkut.

Per vitin 2014 është llogaritur shuma prej **7 500 mije leke**.

000/leke

NR	EMERTIMI	PLANI 2014
		254,99
I	Programi 6260-Sherbime Publike	8
		8,44
II	Programi 4570-Transporti Publik	0
		82,1
III	Programi 4530-Infrastruktura rrugore	59
		1,50
V	Programi 6140 -Urbanistike vendore	0
		66,16
V	Programi 8250-Kultura	8
		59,21
VI	Programi 8140-Sporti	2
		84,74
VII	Programi 9240-Arsimi	5
		41,20
VIII	Programi 10140-Kujdesi Social	5
		176,00
IX	Programi 1110 - Administ. e Bashkise	0
		10,00
X	Programi 4980- Shpenz. te tjera	0
	TOTALI (I-X)	784,427



SHERBIMET PUBLIKE

1. Sherbimi i Pastrimit te Qytetit

Sherbimi pastrimit ne buxhetin 2014 do te realizohet ne zbatim te kontrates se re 5-vjeçare, zbatimi i te ciles ka filluar me daten 1 Tetor 2013.

Plani i vitit 2014, ne mije leke

Nr	Emertimi	Plani 2014
1	Paga	1806
2	Sigurime shoqerore	288
3	Shpenzime operative	111500
	SHUMA	113594

Ne kontraten e re sherbimet kryesore jane:

- Sherbimi mbledhje e transport mbeturina urbane do te realizohet ne te gjithë qytetin. Çdo dite do te transportohen ne vend-depozitim 600 cope kazane mbetje. Nga Siper marrja e sherbimit te Pastrimit do te realizohet cdo dite edhe pastrimi i mbeturinave perreth kazaneve duke i sistemuar neper kazane.
- Ne transportin e mbetjeve eshte shtuar diferenca e transportit me 30 km (vajtje ardhje Shkoder-Bushat).
- Menaxhimi i kazaneve, duke kryer larjen e tyre, riparimet e rrotave, si dhe lyerjen e tyre nga demtimet, do te realizohet cdo muaj sipas planifikimit. Gjithashtu ne kete kontrate parashikohet dhe zevendesimi me 90 kazane te rinj ne vit (54 kazane zona A dhe 36 kazane zona B) nga operatori ekonomik “Borshi shpk”.
- Fshirja e rrugeve me mekanikë dhe me dorë do te kryhet cdo dite sipas siperfaqeve te hartuara ne grafik, ndersa pjesa tjetër e siperfaqeve te rrugeve do te mirembahet cdo dite nga punonjes te kesaj siper marrjeje.
- Larja e rrugeve do te kryhet per 200 dite sipas grafikut te larjes se rrugeve 1 here ne dite dhe 2 here ne dite. Ky proces pune eshte llogaritur te kryhet deri ne oren 08. 00 te mengjesit dhe mbas dite pas ores 18. 00.
- Sipas kontrates se re, operatorit ekonomik i eshte vene detyrim riciklimi i 3% te totalit te mbetjeve, duke zbritur automatikisht 3% nga kostoja totale e kontrates se pastrimit, me synim rritjen e kesaj perqindjeje. Kjo sjell reduktimin direkt te kostos se

depozitimit, gjithashtu redukton edhe impaktin negativ ne mjedis. Dy pika grumbullimi, nje ne pjesen veriore dhe nje ne pjesen jugore te qytetit do te sherbejne si pika per grumbullimin e mbetjeve te diferencuara (plastike dhe leter) per institucionet, bizneset dhe qytetaret. Monitorimi i ketyre pikave do te behet nga supervizoret e Bashkise Shkoder. Ne muajin Shkurt do te filloje nje fushate intensive sensibilizuese per menaxhimin e integruar te mbetjeve. Kjo fushate do te shtrihet ne shkolla, institucione, media, etj. Do te behen perpjekje per perfshirjen e keshilltareve dhe institucioneve te tjera.

- Ne kete vit vazhdon shfrytezimi i landfillit Bushat, prandaj eshte bere parashikimi per koston e menaxhimit te mbetjeve. Efektet financiare jane parashikuar sipas analizave te specialisteve te Bashkise ne masen 386 leke/ton. Ne baze te VKM date 25 Tetor 2013 eshte ngritur Komiteti i Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve, i cili do te percaktoje rregullat e funksionimit, menaxhimit si dhe tarifen per ton te depozitimit ne kete landfill. Nese ky çmim nuk do te jete ne perputhje me analizat tona, do t'i drejtohem Keshillit te Bashkise per ndryshimin e efekteve financiare. Diferenca e transportit per distancen 15 km eshte llogaritur ne shumen 11. 809. 385 leke per 26888 ton.
- Monitorimi i shkarkimit te ngarkeses se mbetjeve ne landfillin Bushat, do te behet me ane te njesise mbikqyrese, pjese e organikes se Bashkise. Ky proces do te perfshije monitorimin e shkarkimit ne teresi, duke kontrolluar peshen e kamioneve te autorizuar nga Bashkia. Njesia monitoruese do te mbaje evidenca te perditshme si dhe do te raportoje ne menyre sistematike prane Bashkise Shkoder per sasine e mbetjeve te depozituara si dhe problematikave te ndryshme qe mund te shfaqen gjate procesit.

Nr	Emertimi i sherbimeve	Njesi	ZONA JUGORE (A)			ZONA VERIORE (B)		
			Sasia	Çmimi	Vlera	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Mbledhje, transport i mbetjeve urbane ne venddepozitimin ekzistues	kazana	131.400	182	23.914.800	87.600	206	18.045.600
2	Menxhim i mbetjeve urbane ne landfillin Bushat (sipas analizes sone)	ton	16632	386	6.419.952	11088	386	4.279.968
3	Menxhim e mirembajtje kazanesh	kazana	360	1.700	612.000	240	1.800	432.000
4	Fshirje mekanike te rrugeve	m2	31.002.553	0,18	5.580.460	30.603.973	0,2	6.120.795
5	Fshirje manuale te rrugeve	m2	25.736.150	0,18	4.459.205	22.296.025	0,2	4.459.205
6	Mirembajtje e 30% te rrugeve	km	20.075	160	3.212.000	20.075	160	3.212.000
7	Larje te rrugeve	m2	-	-	-	32.536.800	0,12	3.904.416
Zbritje 3% ne zerat:								
1	Mbledhje, transport i mbetjeve urbane ne venddepozitimin ekzistues	leke	23.914.800	-3%	-717444	18.045.600	-3%	-541368
2	Menxhim i mbetjeve urbane ne landfillin Bushat (sipas analizes sone)	leke	6.419.952	-3%	-192599	4.279.968	-3%	-128399
Shuma					43.288.374			39.784.217
TVSH 20%					8.657.675			7.956.843
					51.946.049			47.741.060
SHUMA TOTALE ZONA A + ZONA B (leke)								99.687.109
Diference transporti (me TVSH) per dy zonat 15 km								11.809.385
TOTALI								111.496.494

2. Sherbimi i Mirembajtjes se Siperfaqeve te Gjelberta

Plani i vitit 2014, ne mije leke

Nr	Emertimi	Plani 2014
1	Paga	614
2	Sigurime shoqerore	98

3	Shpenzime operative	27710
	SHUMA	28422

Ky shërbim do të kryhet me sipërmarrje nga operatori sipërmarrës.

Sipas preventivave të hartuara, fondi për këto shërbime është në nivel të njëjtit me vitin 2013, në shumën 27.710 mijë lekë sipas pasqyrës së mëposhtme

Pasqyra e shpenzimeve: Mirembajtje sipërfaqe të gjelbërta

Nr.	Emertimi i punimit	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlefë
1	Mirembajtje lulishte (me gjithë elementet e saj)	m2	66000	264. 658	17467428
2	Prodhim fidana lule sezonale	m2	500	504. 691	252346
3	Mirembajtje drurë dekorativ (gjëlberimi rrugor)	cope	4020	474. 661	1908137
4	Mirembajtje shkurre dekorative (rruga M. P. Plaku)	cope	800	244. 511	195609
5	Mirembajtje sipërfaqe ujore	m2	650	931. 556	650511
6	Mirembajtje stola dekorativ	cope	150	2210	331500
7	Mbjellje drurë dekorativ	cope	174	10690	1860060
8	Mbjellje shkurre dekorative	cope	100	2327	2232700
9	Mbjellje bordura të gjëlberta	ml	100	1592. 8	159280
10	Mirembajtje shkurre dekorative në vazo të mëdha	cope	250	315	78750
	Shuma				23091321
	TVSH	20%			4618264
	Shuma totale				27709585

Në preventivat e hartuar për shërbimin e mirembajtjes së sipërfaqeve të gjëlberta do të kryhen këto shërbime:

- Mirembajtjes së lulishteve do të kryhet në një sipërfaqe prej 66 mijë m². Në çdo lulishte do të shërbehet për të gjithë elementet e saj sipas preventivave, ku për çdo 1000 m² lulishte përfshihen: bar i kultivuar 450 m², sipërfaqe lulesh 250 m², sipërfaqe rrugë në lulishte 300 m² si dhe mirembajtje drurë dekorativ, shkurre dekorative e bordurë të gjëlberta.
- Mirembajtje e drurëve dekorativ përfshin mirembajtjen e drurëve të gjëlberimit rrugor, përveç lulishtave. Në preventivin e hartuar përfshihen proceset e krasitjes së tyre, vaditjes, prashitjes si dhe pleherimit për një zhvillim sa më të mirë. Sipas inventarit rezultojnë 4020 drurë dekorativ në rruget kryesore të qytetit.
- Mirembajtja e shkurreve dekorative prej 800 cope përfshin mirembajtjen e shkurreve dekorative në parterin e rruga M. P. Plaku.

- Mirembajtje sipërfaqe ujore prej 650 m² përfshihen punimet e mirembajtjes së shatërvanit në lulishten e Parruces, shatërvani Sheshi Demokracia. Punimet që përfshihen janë pastrimi dhe larja e tyre çdo muaj, si dhe riparimi i pompave dhe elektropompave në raste të defekteve.
- Mbjellja e drurëve, shkurreve dhe bordurave të gjelbërta do të kryhen kryesisht për zëvendësimin e tyre nga tharjet në lulishtat si dhe për plotësim të gjelbërimit rrugor.
- Mirembajtje shkurre dekorative cope 250 në vazo të mëdha. Këto ndodhen në hyrjen e qytetit tona si dhe në Pedonalen e Piacës. Është llogaritur në preventive prashitja, vaditja, mirembajtja e vazove si dhe ndonjë zëvendësim në rast tharjeje apo dëmtimi të pakthyeshem.

3. Shërbimi i Mirembajtjes së Varrezave Publike dhe Dëshmoreve

Realizimi i këtij shërbimi do të kryhet me sipërmarrje me afat 5-vjeçar nga operatori i kontraktuar në Korrik 2013.

Plani i vitit 2014, në mijë lekë

Nr	Emertimi	Plani 2014
1	Paga	128
2	Shpenzime shoqërore	21
3	Shpenzime operative	6314
	TOTALI	6463

Pasqyra e shpenzimeve: Mirembajtje e Varrezave Publike e Dëshmoreve

